



GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Buletini Informativ

Janar — Qershor 2023

Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

Gjykata Kushtetuese

Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS2

VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....5

AKTGJYKIME10

GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME31

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësisë së saj.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

* Gjykata aktualisht përbëhet nga 8 (tetë) gjyqtarë.




Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmuajore: 1 janar – 30 qershor 2023, Gjykata ka pranuar 142 kërkesa të reja, ndërsa ka pasur në punë gjithsej 323 kërkesa/lëndë.

Gjithsej 111 kërkesa janë zgjidhur ose 34.37% e të gjitha rasteve në dispozicion.

Gjatë kësaj periudhe, 120 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës.

*Dinamika e kërkesave të pranura sipas muajve
(1 janar – 30 qershor 2023)*



Në vijim janë paraqitur 17 aktgjykimet që Gjykata i nxori gjatë periudhës gjashtëmuajore, 1 janar – 30 qershor 2023:

- Aktgjykim në rastin KI 214/21, parashtruar nga: Avni Kastrati. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ.nr.84/2021] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 22 shtatorit 2021.
- Aktgjykim në rastin KO 190/19, parashtruar nga: Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve.
- Aktgjykim në rastin KI 143/22, parashtruar nga: Hidroenergji sh.p.k. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [ARJ. UZVP. nr. 51/2022], të datës 19 korrik 2022.
- Aktgjykim në rastin KI 06/21, parashtruar nga: Dragan Mihajloviq. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së

procedurave në Gjykatën e Apelit të Republikës së Kosovës, përkitazi me lëndën Ac. nr. 3930/2016.

- Aktgjykim në rastin KI 36/22, parashtruar nga: “Matkos Group” sh.p.k. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [ARJ. nr. 116/2021], të 28 tetorit 2021.
- Aktgjykim në rastin KI 185/21, parashtruar nga: SHPK “CO COLINA”. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [ARJ. UZVP. nr. 83/2021], të 7 shtatorit 2021.
- Aktgjykim në rastin KI 129/21, parashtruar nga: Velerda Sopi. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë “veprimeve dhe mosveprimeve” të Gjykatës Themelore në Gjilan, Prokurorisë Themelore në Gjilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë.
- Aktgjykim në rastin KI 108/22, parashtruar nga: “Metalinvest” SH.A. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-19-0213] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, të 16 marsit 2022.
- Aktgjykim në rastin KO 100/22, parashtruar nga: Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë dhe në rastin KO101/22, parashtruar nga: Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.
- Aktgjykim në rastin KI 14/22, parashtruar nga: Shpresa Gërvalla. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 409/2020], të 28 shtatorit 2021.
- Aktgjykim në rastin KI 67/22, parashtruar nga: Zeqirja Prebreza. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [CA. Nr. 1343/2021] të 29 dhjetorit 2021, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës.
- Aktgjykim në rastin KI 41/22, parashtruar nga:

Shkumbin Qehaja. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AC-I-21-0867-A001] të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 10 marsit 2022.

- Aktgjykim në rastin KI 85/22, parashtruar nga: Jadran Kostić. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [2022:19820], të 17 majit 2022, të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Aktvendimit [Pn1 Nr. 704/2022] të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, të 31 majit 2022.
- Aktgjykim në rastin KI 69/21, parashtruar nga: Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) dhe Partia Liberale Egjiptiane (PLE). Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [AA.nr.29/2021], të 12 marsit 2021.
- Aktgjykim në rastin KO 139/21, parashtruar nga: Fadil Nura dhe nëntë (9) deputetë tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit (nr. 08-V-040) të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të 21 korrikut 2021, për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave.
- Aktgjykim në rastin KI 212/21, parashtruar nga: Behar Emini. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 382/2021], të 22 shtatorit 2021.
- Aktgjykim në rastin KI 82/22, parashtruar nga: Valon Loxhaj. Në kërkesën e parashtruar u kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev.nr.103/2022], të 30 marsit 2022.

Llojet e shkeljeve të pretenduara

Llojet e shkeljeve të pretenduara nga 142 kërkesat e pranuar gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 janar – 30 qershor 2023, janë si në vijim:


- Neni 3 [Barazia para Ligjit], 12 raste ose 3,5%;
- Neni 7 [Vlerat], 7 raste ose 2%;
- Neni 21 [Parimet e përgjithshme], 10 raste ose 2,9%;
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 15 raste ose 4,4%;
- Neni 23 [Dinjiteti i Njeriut], 8 raste ose 2,3%;
- Neni 24 [Barazia para Ligjit], 48 raste ose 14%;

- Neni 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 2 raste ose 0,6%;
- Neni 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 4 raste ose 1,2%;
- Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 108 raste ose 31,4%;
- Neni 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 22 raste ose 6,4%;
- Neni 36 [E drejta e privatësisë], 2 raste ose 0,6%;
- Neni 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes], 1 rast ose 0,3%;
- Neni 46 [Mbrojtja e pronës], 33 raste ose 9,6%;
- Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 10 raste ose 2,9%;
- Neni 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut], 3 raste ose 0,9%;
- Neni 54 [Mbrojtja gjyqësore e të drejtave], 34 raste ose 9,9%;
- Neni 55 [Kufizimi i të drejtave dhe lirive themelore], 7 raste ose 2%;
- Neni 102 [Parimet e përgjithshme të sistemit gjyqësor], 9 raste ose 2,6%;
- Shkelje të tjera, 9 raste ose 2,6%.

Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 135 kërkesa ose 98% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave;
- 7 kërkesa ose 2% e kërkesave kanë të bëjnë me vendimet e autoriteteve të tjera publike;

Shkelësit e supozuar të të drejtave
(1 janar – 30 qershor 2023)



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese


Gjatë periudhës gjashtëmujore: 1 janar – 30 qershor 2023, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 19 seanca plenare dhe 133 kolegje shqyrtuese, në të cilat rastet e shqyrtuara u zgjidhën me aktgjykime, aktvendime dhe vendime.

Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 120 vendime.

Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 17 Aktgjykime (14,2%);
- 91 Aktvendime për papranueshmëri (75,8%);
- 2 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër (1,6%);
- 1 Vendim për tërheqje të kërkesës (0,8 %);
- 9 Urdhëra të tjerë (7,5 %);

*Struktura e vendimeve të publikuara
(1 janar – 30 qershor 2023)*




Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 109 kërkesa nga shqiptarët, ose 93,1%;
- 7 kërkesa nga komuniteti serb, ose 6%;
- 1 kërkesë nga shtetasit britanik, ose 0,9%;

*Struktura etnike e parashtguesve të kërkesave
(1 janar – 30 qershor 2023)*



13 janar 2023



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe shefi i Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, z. Frank Power, nënshkruan sot në një ceremoni të përbashkët marrëveshjen e grantit të Këshillit të Evropës për Gjykatën Kushtetuese.

Objekt i marrëveshjes për grantin është mbështetja dhe financimi i disa projekteve të destinuara për avancimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të përgjithshme të shërbimeve të teknologjisë informative në Gjykatën Kushtetuese. Përmes fondeve të siguruar nga Këshilli i Evropës, marrëveshja e arritur do të mundësojë blerjen e sistemeve të avancuara harduerike dhe softuerike që do të kontribuojnë në lehtësimin e procesit të menaxhimit të lëndëve, përmirësimin e sistemeve për menaxhimin e bazës së të dhënave dhe avancimin e funksionalitetit të ueb-faqes së Gjykatës Kushtetuese.

Marrëveshja e nënshkruar është pjesë e projektit të Këshillit të Evropës: *“Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese në zbatimin dhe përhapjen e standardeve evropiane të të drejtave të njeriut”*, që u iniciua në janar të vitit të kaluar.

13 janar 2023



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe dekani i

Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, prof. dr. Avni Puka, nënshkruan sot në një ceremoni të përbashkët Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Fakultetit Juridik të UP-së.

Objekt i marrëveshjes së nënshkruar, ndër të tjera, janë zhvillimi i veprimtarive të përbashkëta me qëllim, thellimin dhe shkëmbimin e njohurive në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut, të gjyqësisë kushtetuese dhe sundimit të ligjit, si dhe pjesëmarrja e ndërsjellë në seminare dhe konferenca profesionale.

Pjesë e aktiviteteve të parashikuara në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit janë edhe ligjëratat e kohëpaskohshme të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese para studentëve të Fakultetit Juridik të UP-së, qasja e studentëve të drejtësisë në nivelin master dhe të doktoratës në Bibliotekën e Gjykatës për qëllime akademike dhe kërkimore, si dhe angazhimi i studentëve të Fakultetit Juridik si praktikantë në Gjykatën Kushtetuese.

19 janar 2023



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe drejtori i Projektit për Drejtësi të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) në Kosovë, Artan Hadri, nënshkruan sot në një ceremoni të përbashkët Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe USAID.

Objekt i memorandumit të nënshkruar, ndër të tjera, janë përmirësimi i kapaciteteve institucionale të Gjykatës Kushtetuese për ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët në kërkim të mbrojtjes së të drejtave të tyre themelore të garantuara me Kushtetutë dhe siguri i qasjes më të lehtë të qytetarëve në objektin e Gjykatës.

Aktivitetet e planifikuara në kuadër të memorandumit gjithashtu përfshijnë ndihmën e USAID në organizimin e tryezave të rrumbullakëta ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe përfaqësuesve të shoqërisë

civile dhe mediave. Memorandumi i Mirëkuptimit shënon vazhdimësinë e përkrahjes së USAID për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, si një ndër donatorët dhe mbështetësit kryesor të projekteve të ndryshme të realizuara ndër vite për avancimin e kapaciteteve profesionale dhe infrastrukturore të Gjykatës.

26 janar 2023



Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Remzije Istrefi – Peci, dhe zv. Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, z. Veton Dula, pritën në takim të përbashkët një grup studentësh ndërkombëtarë të Programit Evropian (EMA) për studime pasuniversitare në fushën e të drejtave të njeriut dhe demokratizim, nga kampuset universitare në Vjenë dhe Venedik.

Historiku i themelimit të Gjykatës Kushtetuese dhe i miratimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, roli dhe përgjegjësitë e Gjykatës, si dhe juridiksioni dhe palët e autorizuara për parashtrimin e kërkesave ishin vetëm disa ndër temat për të cilat gjyqtarja Istrefi – Peci diskutoi gjatë prezantimit të saj.

Gjyqtarja Istrefi – Peci në vazhdim i njoftoi studentët ndërkombëtarë edhe për zbatimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe obligimin kushtetues për respektimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

Pas prezantimit që zv. Sekretari i Përgjithshëm Dula i bëri strukturës aktuale të Gjykatës dhe përbërjes së saj të parë me gjyqtarë dhe këshilltarë ndërkombëtarë, studentët shprehën interesimin e tyre që të informohen më për së afërmi përkitazi me natyrën e vendimeve që i nxjerr Gjykata Kushtetuese, arsyet më të shpeshta për shpalljen e kërkesave të parashtruara si të papranueshme dhe për kohëzgjatjen e shqyrtimit të rasteve.

6 shkurt 2023

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Lisbonë të Portugalisë, më 30 janar - 3 shkurt 2023, me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të



Evropës në Kosovë, në kuadër të projektit “Mbështetja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në zbatimin dhe përhapjen e standardeve evropiane të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”.

Gjatë qëndrimit trefitor në Portugali, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese dhe Ambasadori i Kosovës në Portugali, Sh.T. Ylber Kryeziu, zhvilluan takime me Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën Supreme të Drejtësisë, Gjykatën Supreme Administrative dhe përfaqësues të Parlamentit të Republikës së Portugalisë.

Në Gjykatën Kushtetuese të Portugalisë, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u mirëprit nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese të Portugalisë, z. João Pedro Barrosa Caupers dhe gjyqtarët tjerë, të cilët së bashku diskutuan për juridiksionet e të dy gjykatave, karakteristikat e sistemit portugez në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me fokus të veçantë në kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore në kohë emergjencash dhe jurisprudencën e të dy gjykatave në lidhje me pandeminë Covid-19.



Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës gjithashtu vizitoi Gjykatën Supreme të Drejtësisë të Portugalisë, ku u mirëprit nga Kryetari i saj, z. Henrique Luís de Brito de Araújo dhe gjyqtarët tjerë, me të cilët diskutuan bashkërisht për funksionet, kompetencat dhe përbërjen e kësaj gjykate. Ndërsa,

gjatë vizitës në Gjykatën Supreme Administrative, delegacioni i Kosovës u mirëprit nga Kryetarja e kësaj gjykate, znj. Dulce Manuel da Conceição Neto dhe gjyqtarët tjerë, ku temë e diskutimit të përbashkët ishin po ashtu juridiksioni, përbërja dhe puna e këtij institucioni. Gjatë vizitës në të tri gjykatat respektive, delegacionet u dakorduan edhe për mekanizmat e thellimit të bashkëpunimit në të ardhmen. Delegacioni i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës u takua edhe me deputetë të Parlamentit të Portugalisë, gjatë të cilit takim diskutuan për drejtësinë kushtetuese dhe rëndësinë e saj në avancimin e parimit të sundimit të ligjit, si dhe për rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit në mes të institucioneve të drejtësisë të të dyja vendeve.

13 shkurt 2023



Një grup prej 15 arsimtarësh të lëndës “Edukata Qytetare” në shkollat fillore të komunës së Fushë-Kosovës, Shtimes, Vitisë, Prizrenit dhe Prishtinës vizituan Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, në kuadër të programit të trajnimit “*Fuqizimi i të rinjve – Avancimi i sundimit të ligjit dhe edukimi mbi të drejtat e njeriut në shkollë*”, i mbështetur nga Misioni i EULEX-it në Kosovë dhe që zbatohet nga organizata joqeveritare Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR-KS).

Arsimtarët u pritën në takim nga gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Nexhmi Rexhepi, i cili në mes tjerash, i njoftoi ata përkitazi me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese dhe palët e autorizuar për parashtrimin e kërkesave, për përbërjen e gjyqtarëve kushtetues dhe procesin e zgjedhjes së tyre, si dhe për vendimmarrjen e Gjykatës dhe mekanizmat në dispozicion për monitorimin e zbatueshmërisë së tyre.

Ndër çështjet për të cilat arsimtarët shprehën interesimin e tyre që të informohen më në detaje për sa i përket punës dhe veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese, ishte edhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues, mandati i tyre si gjyqtarë dhe mënyra e votimit gjatë trajtimit të lëndëve.

16 shkurt 2023

Në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës u mbajt punëtorja informuese me gjyqtarë dhe

prokurorë të sapoemëruar, e organizuar në kuadër të programit të trajnimit fillestar nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës.



Gjyqtarët dhe prokurorët e rinj u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka – Nimani, e cila gjatë prezantimit fillimisht diskutoi përkitazi me rolin dhe juridiksionin që ka Gjykata në sistemin juridik të Republikës së Kosovës, për strukturën organizative dhe përbërjen e saj, si dhe palët e autorizuar për parashtrimin e kërkesave.

Kryetarja Caka – Nimani në vijim foli më në detaje për kriteret e pranueshmërisë dhe trajtimin e kërkesave të parashtruara, për raportet e Gjykatës Kushtetuese me gjykatat e niveleve të tjera në vend, si dhe për mundësitë që nëpërmjet mekanizmit të kontrollit incidental gjykatat e rregullta t'i drejtohen Gjykatës për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së një ligji, që mund të jetë kontestuar gjatë procedurës gjyqësore.

Gjatë bashkëbisedimit, gjyqtarët dhe prokurorët e rinj shprehën interesimin e tyre që të informohen më hollësisht lidhur me rastet kur Gjykata mund të rishikojë praktikën e saj gjyqësore, dallimin në mes të kontrollit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së akteve, si dhe për aspekte të ndryshme të procedurës së referimit të kërkesave përmes kontrollit incidental dhe kriteret mbizotëruese për të vendosur nëse kushtetutshmëria e një ligji duhet të referohet në Gjykatën Kushtetuese.

31 mars 2023



Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i udhëhequr nga Kryetarja e Gjykatës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE), me seli në Luksemburg, më 27-28 mars 2023. Në ditën e parë të vizitës, delegacioni i Gjykatës Kushtetuese fillimisht u prit në takim nga

Zëvendëskryetari i GJDBE-së, z. Lars Bay Larsen dhe Avokati i Parë i Përgjithshëm, z. Maciej Szpunar, me të cilët, Kryetarja Caka-Nimani dhe gjyqtarët e tjerë kushtetues, bashkëbiseduan përkitazi me funksionin dhe kompetencat që ka kjo gjykatë në kuadër të strukturave të drejtësisë të Bashkimit Evropian. Kryetarja i njoftoi rreth juridiksionit, kompetencave dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, përfshirë rolin dhe rëndësinë e praktikës së GJDBE-së në veendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese. Takimi i përbashkët vazhdoi me pjesëmarrjen e gjyqtarëve të dy gjykatave në tryezën e rrumbullakët me temë: “Karta e të Drejtave Themelore të BE-së”, ku në mesin e folësve kryesor ishte edhe Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani. Përgjatë kësaj tryeze, u diskutua gjithashtu ndërveprimi në mes të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe ndërveprimi në mes të GJDBE-së dhe GJEDNJ-së për sa i përket kësaj fushe të juridiksionit.

Në ditën e dytë të vizitës, Kryetarja Caka-Nimani u prit në takim nga Kryetari i GJDBE-së, z. Koen Lenaerts, me të cilin diskutuan rreth mundësive të bashkëpunimit në mes të dy gjykatave. Gjithashtu, delegacioni i Gjykatës mori pjesë në një seancë publike të Dhomës së Madhe të GJDBE-së.

Vizita e delegacionit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit Evropian u përmbyllë me diskutime të përbashkëta me Kryetarë Dhomash të Gjykatës së Drejtësisë, gjyqtarë të kësaj gjykate dhe të Gjykatës së Përgjithshme.

10 maj 2023



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani, qëndroi për vizitë zyrtare në Tiranë. Vizita e kryetares Caka – Nimani në kryeqytetin shqiptar u organizua nga Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, me

ftesën për të marrë pjesë në Konferencën ndërkombëtare të organizuar në shënim të 110-vjetorit të themelimit të kësaj gjykate, në temën: “Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, nga identiteti kombëtar

tek vlerat universale”. Gjatë qëndrimit në Tiranë, kryetarja Caka – Nimani u prit në takime të veçanta nga Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, z. Sokol Sadushi, dhe nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, znj. Holta Zaçaj. Temë e diskutimit të përbashkët në të dyja takimet ishte thellimi i mëtutjeshëm i marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit me gjykatat respektive dhe përpjekjet e përbashkëta për forcimin e sundimit të ligjit në të dyja vendet.

19 maj 2023



Një grup studentësh të vitit të parë të Fakultetit Juridik në kuadër të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”, me në krye profesorin e këtij universiteti, Prof. dr. Kadri Kryeziu, qëndruan për vizitë në Gjykatën Kushtetuese.

Studentët u pritën në takim nga kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese, z. Safet Hoxha.

Pasi që u shprehu mirëseardhjen, kryetarja Caka – Nimani i njoftoi juristët e ardhshëm me funksionin që ka Gjykata Kushtetuese në raport me pushtetet e tjera në vend dhe me rolin me rëndësi që ka luajtur ajo ndër vite në vendosjen dhe mbrojtjen e themeleve të rendit kushtetues. Në vazhdim ajo foli edhe për procesin e vendimmarrjes së Gjykatës dhe referimit të vazhdueshëm që në çdo vendim të saj i bëhet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kryetarja Caka – Nimani në fund i porositi studentët që të angazhohen sa më shumë në studimet e tyre universitare dhe në përvetësimin e njohurive profesionale, me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të strukturës ligjore të vendit përballë sfidave të së ardhmes.

Në prezantimin e tij para studentëve të UPZ-së, gjyqtari Safet Hoxha ndërkaq bëri një elaborim të shkurtër përkitazi me strukturën dhe përbërjen e Gjykatës Kushtetuese, me procesin e parashtrimit të kërkesave dhe trajtimin e tyre deri në vendimmarrjen e gjyqtarëve.

9 qershor 2023

Një delegacion i gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës i përbërë nga zëvendëskryetari i Gjykatës, z. Bajram Ljatifi dhe gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu – Krasniqi, Safet Hoxha dhe Radomir Laban, mori pjesë në një punëtori të përbashkët me gjyqtarët e gjykatave themelore të Gjakovës, Pejës dhe Prizrenit, e cila u organizua me mbështetjen e Zyrës së Këshillit të Evropës në qytetin e Gjakovës.

Temë e diskutimit të përbashkët të gjyqtarëve kushtetues dhe të gjyqtarëve të tri gjykatave themelore ishin, ndër të tjerash, ndërveprimi i juridiksionit gjyqësor dhe kushtetues për garantimin e shtetit të së drejtës, dhe administrimi i duhur i drejtësisë në kontekst të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Roli i gjykatave të rregullta në interpretimin e Kushtetutës, baza juridike dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese në raport me “kontrollin incidental”, divergjenca e praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta dhe e drejta për një vendim të arsyetuar gjyqësor, si dhe vendosja e rasteve brenda një afati të arsyeshëm dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese, ishin disa prej temave të cilat gjyqtarët kushtetues i trajtuan në prezantimet e tyre.

Punëtorja e mbajtur shënon vazhdimësinë e takimeve konsultative profesionale ndërmjet gjyqtarëve kushtetues dhe gjyqtarëve të gjyqësorit të rregullt, në shërbim të përmirësimit të administrimit të drejtësisë dhe forcimit të sundimit të ligjit në vend.

30 qershor 2023

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë morën pjesë në një punëtori të përbashkët që u organizua në “Hotel Swiss Diamond” në Prishtinë. Ankimi kushtetues, si e drejtë

substanciale, gjykimi brenda një kohe të arsyeshme dhe kontrolli i kushtetutshmërisë së ligjeve, ishin vetëm disa ndër temat të cilat u trajtuan në prezantimet dhe diskutimet e gjyqtarëve kushtetues të të dyja vendeve.



Me të përfunduar të punëtorisë, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Gresa Caka – Nimani dhe gjyqtarët e tjerë kushtetues, pritën në takim të përbashkët në ambientet e gjykatës delegacionin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, në krye me kryetaren e kësaj gjykate, znj. Holta Zaçaj.



Temë e diskutimit të përbashkët ishin të arriturat e deritanishme në fushën e drejtësisë kushtetuese të të dyjave vendeve, përpjekjet e bëra për modernizimin e sistemeve elektronike për menaxhimin e rasteve dhe për unifikimin e praktikave gjyqësore, si dhe sfidat kryesore në funksionimin e të dy gjykatave dhe përvojat reciproke në tejkalimin e tyre.



Aktgjykim

KO 190/19

Parashtrues

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës shqyrtoi kërkesën KO 190/19, të parashtruar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në të cilën u kërkuar që të bëhet vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontribut pagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve.

Bazuar në kërkesën e parashtruar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës sipas paragrafit 8 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Gjykata ka vlerësuar kushtetutshmërinë e paragrafit 2 të nenit 8 (Kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës) të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 (Kualifikimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues) dhe nenin 6 (Dokumentet e nevojshme për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues) të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2015 për “Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional”.

Gjykata, njëzëri, vendosi që (i) kërkesa është e pranueshme; dhe (ii) paragrafi 2 i nenit 8 të Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti në lidhje me nën-paragrafin 2.3 të paragrafit 2 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ nr.09/2015 për “Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve-Stazhit Pensional”, nuk janë në përputhshmëri me nenin 24 [Barazia para Ligjit] në lidhje me nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 (Ndalimi i Përgjithshëm i Diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjykata thekson që Gjykata referuese, bazuar në pesë (5) konteste në shqyrtim para saj dhe që ndërlidhen me të drejtën e palëve përkatëse për pension kontributpagues, ka kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit në lidhje me Udhëzimin Administrativ të aplikueshëm dhe të kontestuar në këtë rast, sa i përket kriterit të përvojës së punës në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh para 1 janarit 1999, në rrethanat historike dhe politike të viteve të ‘90-ta, përgjatë të cilave, pjesa dërrmuese e të punësuarve, ishin larguar nga vendet e tyre të punës bazuar në ligje diskriminuese.

Në kontekst të pretendimeve të Gjykatës referuese, Gjykata fillimisht sqaron se objekt i vlerësimit kushtetues në këtë rast është vetëm dispozita përkatëse e Ligjit të kontestuar në lidhje me Udhëzimin përkatës Administrativ, e që ndërlidhet vetëm me kategorinë e pensionit kontributpagues dhe jo kategoritë e pensioneve tjera të përcaktuara me të njëjtin ligj dhe as ligjet tjera të veçanta dhe të cilat përbëjnë tërësinë e skemave pensionale aktualisht të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Ndërsa, përkitazi me kategorinë e pensionit kontributpagues, Gjykata sqaron se i njëjti buron nga Ligji për Sigurimin Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83, i publikuar në Gazetën Zyrtare të KSAK-së nr.26/83 dhe të cilin, Kuvendi i Republikës së Kosovës, e ka përvetësuar përmes Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Ky i fundit, përcakton vlefshmërinë e kësaj kategorie pensionesh vetëm për përvojën e punës deri më 1 janar 1999, duke saktësuar që për njohjen e të drejtës në këtë kategori pensionesh, qytetarët duhet të kenë stazh pensional të dëshmuar sipas ligjit të lartcekur të ish-KSAK-së. Megjithatë, Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, kategorizon përfituesit e mundshëm të pensionit kontributpagues në dy grupe. I pari, i përcaktuar përmes paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar dhe i cili përbëhet nga “punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”, dhe të cilëve,

përmes Ligjit të lartcekur, “ju njihet stazhi i punës për pension kontributdhënës për vitet 1989-1999”. Ndërsa, i dyti, i përcaktuar përmes paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar dhe i cili përbëhet nga të gjithë qytetarët tjerë që mund të kualifikohen për të drejtën në pension kontributpagues, kriteret për realizimin e të drejtës së të cilëve, delegohen në nivel të aktit nënligjor dhe i cili përcakton kategorizimin e qytetarëve/shfrytëzuesëve të pensionit kontributpagues “sipas kohëzgjatjes së pagesës së kontributit sipas strukturës kualifikuese”. Kohëzgjatja dhe struktura kualifikuese është saktësuar përmes Udhëzimit të kontestuar Administrativ, dhe i cili, ndër tjerash, përcakton kriterin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh përvojë pune/pagesë kontributësh në ish-fondin përkatës të sigurimit pensional të përcaktuar përmes ligjit të lartcekur të ish-KSAK-së. Pa marrë parasysh dallimin në mes këtyre dy kategorive siç është përcaktuar në Ligjin e kontestuar dhe/ose kohëzgjatjen e pagesës së kontributeve deri më 1 janar 1999, mjetet financiare për këtë kategori pensionesh, përkatësisht për të dy grupet e lartcekura, sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.

Bazuar në kontekstin e lartcekur dhe pretendimet e Gjykatës referuese, Gjykata thekson se thelbi i kësaj kërkesë kushtetuese është që të vlerësohet nëse, në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 dhe nenin 1 të Protokollit nr. 12 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, (i) grupi i dytë i qytetarëve që mund të kualifikohen për të drejtën në pension kontributpagues, janë të diskriminuar në raport me ata të grupit të parë, përkatësisht “punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës” dhe të cilëve u njihet “stazhi i punës për pension kontributdhënës” për vitet 1989-1999; dhe (ii) aplikimi i kriterit për përvojë pune/kontribut prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh përgjatë viteve të ‘90-ta, përgjatë të cilave shumicës dërrmuese të të punësuarve i është ndërprerë marrëdhënia e punës, si rezultat i aplikimit të ligjeve diskriminuese, është kriter i arsyeshëm dhe proporcional.

Për këtë qëllim, Gjykata shtjelloi dhe aplikoi kriteret që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe e Gjykatës përkitazi me testin e diskriminimit, bazuar në të cilin, fillimisht duhet të vlerësohet nëse ka “dallim në trajtim” në mes individëve/grupeve përkatëse dhe të cilat janë në situata të ngjashme dhe/ose analoge, dhe nëse ky është rasti, të vlerësojë nëse dallimi përkatës në trajtim (i) është “i përcaktuar me ligj”; (ii) ka ndjekur një “qëllim legjitim”; dhe (iii) është “proporcional”.

Në këtë kontekst, Gjykata, ndër të tjerash, theksoi se

(i) nuk është kontestuese që ka “dallim në trajtim” në mes dy grupeve/kategorive të qytetarëve dhe të cilët janë në situata të ngjashme dhe/ose analoge përkitazi me fushëveprimin e kategorisë së pensioneve kontributpaguese dhe se ky “dallim në trajtim” është i “përcaktuar me ligj”, përkatësisht për grupin e parë përmes paragrafit 6 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar, ndërsa për grupin e dytë përmes paragrafit 2 të nenit 8 të Ligjit të kontestuar në lidhje me nenin 6 të Udhëzimit të kontestuar Administrativ; (ii) ky “dallim në trajtim” ndjek një “qëllim legjitim”, përkatësisht dhe ndër tjerash, atë të stabilitetit financiar dhe ekonomik të shtetit; por që (iii) i njëjti nuk është i arsyeshëm dhe proporcional. Kjo e fundit sepse (i) Ligji i kontestuar bën dallimin në mes dy kategorive të qytetarëve, në kontekst të kategorisë së pensionit kontributpagues, duke përcaktuar, në njërën anë, se stazhi i punës për pension kontributpagues për vitet 1989-1999, njihet për “punëtorët e arsimit, shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës”, ndërsa në anën tjetër, duke përcaktuar se për kategoritë tjera të qytetarëve që mund të kualifikohen për të drejtën në pension kontributpagues, kriteret për njohjen e stazhit përkatës kontributpagues, duhet të përcaktohen me akt nënligjor; (ii) përkundër faktit që Ligji i kontestuar, në paragrafin 2 të nenit 8 të tij, saktëson që kriteret dhe kushtet për fitimin e të drejtës në pension kontributpagues, përcaktohen sipas “kohëzgjatjes së pagesës së kontributit”, përmes një akti nënligjor, ky i fundit, përkatësisht Udhëzimi i kontestuar Administrativ, në mënyrë krejtësisht formaliste aplikon kriterin prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh dëshmi përvojë/kontributi, në rrethana historike dhe politike, në kontekst të të cilave, realizimi i këtij kriteri, ishte pamundësuar bazuar në ligje diskriminuese për shumicën dërrmuese të qytetarëve; (iii) e gjithë kategoria e qytetarëve që nuk e plotësojnë kriterin e të dëshmuarit së përvojës/kontributit për pesëmbëdhjetë (15) vite, trajtohen njëjtë me të gjithë tjerët që nuk kanë bërë asnjë pagesë të kontributeve për stazhin pensional para viti 1999; dhe (iv) pa marrë parasysh kontributet e qytetarëve përkatës, përfshirë kohëzgjatjen e tyre, në ish-fondin përkatës pensional bazuar në Ligjin e ish-KSAK-së, e tërë kategoria e qytetarëve që mund të jenë përfituese të kategorisë së pensionit kontributpagues, është e financuar nga buxheti i Republikës së Kosovës. Në mbështetje të konstatimit të mungesës së marrëdhënies së proporcionalitetit ndërmjet kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, Gjykata mori parasysh edhe Raportin me Rekomandime ex officio nr. 235/2018 të Avokatit të Popullit në lidhje me “kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit

1999 dhe nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues të moshës për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 viteve si pasojë e largimit diskriminues nga puna”.

Përkitazi me efektet e këtij Aktgjykimi, Gjykata fillimisht thekson që bazuar në paragrafin 3 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shfuqizimi i ligjit ose dispozitës përkatëse, hyn në fuqi në ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës, përpos nëse Gjykata vendosë ndryshe. Kjo e fundit, në përputhje edhe me parimet që burojnë nga Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, i mundëson Gjykatës fleksibilitetin e nevojshëm për të përcaktuar efektet kohore të Aktgjykimeve të saj. Megjithatë, duke marrë parasysh rrethanat specifike të rastit konkret dhe pasojat potencialisht të paparashikueshme të shfuqizimit të menjëhershëm të dispozitave jokushtetuese dhe zbrazëtirës pasuese juridike dhe me qëllim të balancimit në mes të të drejtave dhe lirive themelore dhe parimit të sigurisë juridike, Gjykata iu referua Opinioneve relevante të Komisionit të Venecias dhe kërkoi edhe mendimin e Gjykatave Kushtetuese anëtare të Forumit të Komisionit të Venecias.

Emëruesi i përbashkët i përgjigjeve përkatëse të pranuar nga këto të fundit, në parim, reflekton që (i) Gjykatat Kushtetuese, kanë një fleksibilitet të caktuar përkitazi me përcaktimin e efekteve kohore të një Aktgjykimi; (ii) në parim, ligjet/dispozitat përkatëse të cilat janë vlerësuar në kundërshtim me Kushtetutën, duhet të shfuqizohen menjëherë dhe të eliminohen nga sistemi përkatës juridik; por që, (iii) në rrethana specifike, dhe për të shmangur pasojat potenciale si rezultat i shfuqizimit të menjëhershëm të ligjit/dispozitës së kontestuar, ndonjëherë është e nevojshme të shtyhet zbatimi/hyrja në fuqi e një Aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, duke i lënë mundësinë pushteteve tjera, përkatësisht atij ekzekutiv dhe legjislativ, që të ndërmarrin masat e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e dispozitës së shpallur si kundërkushtetuese në përputhje me Kushtetutën edhe Aktgjykimin përkatës të Gjykatës Kushtetuese; dhe në fund, (iv) në parim, duhet të evitohen efektet prapavepruese të Aktgjykimeve përkatëse, me theks në vendimet gjyqësore të formës së prerë, në favor të parimit të sigurisë juridike.

Bazuar në këto parime dhe sqarimet e shtjelluara në Aktgjykimin që do të publikohet, Gjykata vlerësoi se në rrethanat e rastit konkret, siguria juridike mbrohet në mënyrë më efektive duke përcaktuar shfuqizimin e dispozitave të vlerësuara si në kundërshtim me Kushtetutën pas një periudhe gjashtë (6) mujore, përkatësisht më 15 korrik 2023, në mënyrë që (i) të

evitohet zbrazëtia juridike e cila, ndër tjerash, mund të afektojë negativisht edhe qytetarë të cilët mund të përfitojnë nga dispozitat përkatëse të Ligjit të kontestuar në lidhje me Udhëzimin Administrativ të kontestuar; dhe (ii) t'i akordohet një periudhë kohore e arsyeshme Kuvendit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht, që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e nenit 8 të Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim.



Aktgjykim

KI 185/21

Parashtrues

“CO COLINA” sh.p.k.

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit dhe Aktgjykimin të Gjykatës Supreme [ARJ. UZVP. nr. 83/2021], të 7 shtatorit 2021

Rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me ndërprerjen e ushtrimit të aktivitetit të bastores sportive të parashtruesit të kërkesës, aktivitet ky që ishte ushtruar në bazë të licencave të lëshuara nga Administrata Tatimore e Kosovës sipas Ligjit nr. 04/L-080 për Lojërat e Fatit. Bazuar në këtë të fundit, licenca e fundit që i ishte lëshuar parashtruesit të kërkesës për të ushtruar këtë aktivitet, ishte e vlefshme nga data 8 gusht 2018 deri më 7 gusht 2019. Megjithatë, më 10 maj 2019, hyri në fuqi Ligji nr. 06/L-155 për Ndalimin e Lojërave të Fatit, sipas të cilit, të gjitha lojërat e fatit në territorin e Republikës së Kosovës u mbyllën dhe u ndaluan. Si pasojë dhe në zbatim të Ligjit të lartcekur, Drejtoria e Lojërave të Fatit brenda Administratës Tatimore të Kosovës, kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës për revokimin e licencës së biznesit të tij, me efekt të menjëhershëm, përkatësisht nga 10 maji 2019, pra para skadimit të saj më 7 gusht 2019. Ndaj Njoftimit për revokim të licencës dhe pas refuzimit të ankesës nga Administrata Tatimore e Kosovës,

parashtruesi i kërkesës dorëzoi padi për konflikt administrativ në Gjykatën Themelore, duke kërkuar anulimin e Njoftimit për revokim të licencës me pretendimin se, mes tjerash, (i) si rezultat i revokimit të licencës para afatit të skadimit atij i ishte cenuar e drejta në pronë sipas nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës; (ii) se i njëjti, përkatësisht Njoftimi ishte i bazuar në Ligjin për Ndalimin e Lojërave të Fatit, duke pretenduar se ky i fundit ishte në kundërshtim me Kushtetutën; si dhe (iii) i propozoi Gjykatës Themelore që nëse e njëjta kishte dyshime lidhur me kushtetutshmërinë e këtij Ligji, t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese përmes procedurës së "kontrollit incidental" bazuar në paragrafin 8 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës, paralelisht me paraqitjen e padisë së lartcekur, iu drejtua edhe Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar se Ligji për Ndalimin e Lojërave të Fatit afektonte drejtpërdrejtë të drejtat e tij dhe ishte në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës, duke kërkuar shfuqizimin e të njëjtit. Gjykata Kushtetuese, në rastin KI136/19 e kishte shpallur të papranueshme kërkesën e parashtruesit të kërkesës, duke konstatuar se e njëjta është e parakohshme, për faktin se parashtruesi i kërkesës kishte filluar procedurat gjyqësore në lidhje me Njoftimin për revokim të licencës.

Përgjatë zhvillimit të procedurës në gjykatat e rregullta, Gjykata Themelore e refuzoi si të pabazuar padinë e parashtruesit të kërkesës lidhur me revokimin e licencës nga Administrata Tatimore e Kosovës, duke arsyetuar se (i) revokimi i licencës ishte i ligjshëm pasi i njëjti ishte bazuar në Ligjin për Ndalimin e Lojërave të Fatit; (ii) në procedurën për konflikt administrativ, Gjykata Themelore ka kompetencë vetëm për të vlerësuar ligjshmërinë e aktit dhe jo shkeljen e të drejtave kushtetuese të parashtruesit të kërkesës; dhe (iii) përkundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për kundër kushtetutshmërinë e Ligjit bazuar në të cilin i ishte revokuar licenca para skadimit të afatit, nuk iu drejtua Gjykatës Kushtetuese përmes "kontrollit incidental", për të kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitës kontestuese. Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme konfirmuan arsyetimin e Gjykatës Themelore.

Parashtruesi i kërkesës iu drejtuar sërish Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së (i) Ligjit për Ndalimin e Lojërave të Fatit; dhe (ii) vendimeve të gjykatave të rregullta, duke pretenduar se i është shkelur e drejta e gëzimit paqësor të pronës sipas nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat

e Njeriut, si rezultat i revokimit të licencës dhe lejes së punës së vlefshme, përkatësisht, ndalimit të menjëhershëm të veprimtarisë ekonomike. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me arsyetimin se (i) gjykatat e rregullta është dashur që të vlerësojnë pretendimet e tij për shkeljen e së drejtës në pronë si rezultat i Ligjit të kontestuar dhe Njoftimit pasues të ATK-së; ose (ii) në rast dyshimi, t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Ndalimin e Lojërave të Fatit.

Sa i përket vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit për Ndalimin e Lojërave të Fatit, Gjykata vlerësoi se, sipas praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për të kontestuar një ligj drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetuese, mes tjerash, është e nevojshme që parashtruesi i kërkesës të jetë drejtpërsëdrejti i afektuar nga ligji në fjalë dhe që të mos ketë akt të ndërmjetëm, përkatësisht masë zbatuese nga autoriteti publik lidhur me ligjin në fjalë. Lidhur me këtë, Gjykata duke u referuar në vendimmarrjen e saj të vitit 2019 përkitazi me parashtruesin e kërkesës, përkatësisht Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin KI136/19, ritheksoi se në rastin konkret kishte ekzistuar një masë zbatuese lidhur me Ligjin në fjalë, përkatësisht, Njoftimi i Administratës Tatimore, përmes së cilit ishte revokuar licenca e parashtruesit të kërkesës para skadimit të afatit të saj, dhe të cilën parashtruesi i kërkesës e kishte kontestuar në gjykata të rregullta. Andaj, në këto rrethana, Gjykata theksoi se e njëjta, në mungesë të një pale të autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e ligjit në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Kushtetutës, nuk mund të shqyrtojë kushtetutshmërinë e Ligjit për Lojërat e Fatit, por vetëm kushtetutshmërinë e vendimeve gjyqësore lidhur me revokimin e licencës së parashtruesit të kërkesës.

Në kontekst të vlerësimit të kushtetutshmërisë së vendimeve të gjykatave të rregullta, Gjykata konstatoi se të njëjtat ishin nxjerrë në kundërshtim me (i) nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (ii) nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përkitazi me shkeljen e konstatuar lidhur me nenin 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata theksoi që, sipas praktikës së saj dhe asaj të

Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në vlerësimin e shkeljeve të lartcekura, fillimisht duhet të përcaktojë, nëse përmes akteve të kontestuara, përkatësisht vendimeve të gjykatave të rregullta (i) ka pasur “ndërhyrje” në të drejtën për gëzim paqësor të pronës në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, dhe nëse ky ishte rasti, të vlerësojë nëse “ndërhyrja” përkatëse është (ii) e “përcaktuar me ligj”; (iii) ka ndjekur një “qëllim legjitim”; si dhe (iv) është “proporcionale”. Në këtë kontekst, Gjykata theksoi se me revokimin e licencës së vlefshme përmes Njoftimit të Administratës Tatimore të Kosovës, ka pasur “ndërhyrje” në të drejtën e pronës së parashtruesit të kërkesës, sepse bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, “licenca” përbën “pronë” për qëllime të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Më tej, Gjykata gjithashtu sqaroi që “ndërhyrja” që kishte rezultuar si rezultat i vendimeve të gjykatave të rregullta, (i) ishte “përcaktuar me ligj”, përkatësisht në Ligjin për Ndërpërjen e Lojërave të Fatit; dhe (ii) ndiqte një “qëllim legjitim”, megjithatë (iii) nuk ishte “proporcionale”, sepse parashtruesi i kërkesës, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ndër tjerash, kishte pritje legjitime që gjatë periudhës për të cilën kishte pasur licencën dhe lejen e punës së vlefshme, bazuar në Ligjin paraprak për Lojërat e Fatit, ai do të mund të ushtronte aktivitetin e tij ekonomik dhe të gëzonte në mënyrë paqësore pronën e tij.

Ndërsa, përkitazi me shkeljen e konstatuar lidhur me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata, ndër të tjera, theksoi se në kundërshtim me garancitë që ngërthejnë nenet e lartcekura, gjykatat e rregullta (i) nuk kishin zbatuar garancitë kushtetuese në vlerësimin e ligjshmërisë së revokimit të licencës së vlefshme të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht pretendimeve përkatëse për shkeljen e të drejtës në pronë siç është e garantuar me Kushtetutë; dhe për më tepër, (ii) nuk kishin dhënë arsyetim adekuat për mosreferim të çështjes në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit kontestues, përkundër kërkesave të vazhdueshme të parashtruesit të kërkesës.

Në fund, dhe përkitazi me efektin e këtij Aktgjykimi, Gjykata theksoi se, në interes të sigurisë juridike, ky Aktgjykim prodhon efekt juridik vetëm ndërmjet palëve në procedurë dhe nuk mund të prodhojë efekt prapaveprues juridik lidhur me personat e tjerë fizikë dhe juridikë që mund të kenë ushtruar veprimtarinë e lojërave të fatit bazuar në Ligjin për Lojërat e Fatit. Gjykata më tej theksoi se, parashtruesi i kërkesës në

procedurën pranë gjykatave të rregullta mund të kërkojë kompensim të drejtë për shkeljen e të drejtave kushtetuese të konstatuara përmes këtij Aktgjykimi, përfshirë kompensimin e mundshëm për kohëzgjatjen sa parashtruesi i kërkesës kishte licencë të vlefshme, pra nga data 10 maj 2019, kur kishte filluar efekti i revokimit të licencës, deri më 9 gusht 2019, kur skadonte licenca e parashtruesit të kërkesës për të ushtruar veprimtarinë e tij, bazuar në ligjin paraprak, përkatësisht Ligjin për Lojërat e Fatit.

Përfundimisht, bazuar edhe në sqarimet e dhëna në Aktgjykimin e publikuar, Gjykata konstatoi se, Aktgjykimi [ARJ. UZVP. nr. 83/2021] i Gjykatës Supreme, i 7 shtatorit 2021, në lidhje me Aktgjykimin [AA. nr. 242/2021] të Gjykatës së Apelit, të 8 qershorit 2021, dhe Aktgjykimin [A. nr. 1861/21] e Gjykatës Themelore në Prishtinë të 9 shkurtit 2021, nuk janë në përputhshmëri me (i) nenin 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 (Mbrotja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; si dhe (ii) nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E Drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe se të njëjtat, si të tilla, shfuqizohen.



Aktgjykim

KI 129/21

Parashtrues

Velerda Sopi

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së “veprimeve dhe mosveprimeve” të Gjykatës Themelore në Gjilan, Prokurorisë Themelore në Gjilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë

Bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës pala parashtruese para Gjykatës kontestoi “veprimet dhe mosveprimet” e autoriteteve shtetërore, përkatësisht, Gjykatës Themelore në Gjilan,

Prokurorisë Themelore në Gjilan, Stacionit Policor në Graçanicë dhe Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe të cilat sipas saj, rezultuan në cenimin e të drejtës për jetë të nënës së saj, përkatësisht të ndjerës S.M., në kundërshtim me: (i) të drejtën për jetë të garantuar me nenin 25 [E drejta për Jetën] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 2 (E drejta për jetën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (ii) detyrimet e autoriteteve shtetërore të përcaktuara me nenet 18 (Detyrimet e Përgjithshme), 50 (Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëhershme) dhe 51 (Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut) të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, përkatësisht Konventës së Stambollit.

Gjykata, njëzëri vendosi që kërkesa është e pranueshme dhe konstatoi se Policia e Kosovës, përkatësisht Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokurori i Shtetit, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prishtinë, kanë dështuar në përmbushjen: (i) e detyrimeve të tyre pozitive për mbrojtje të jetës së S.M.-së, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 25 [E Drejta për Jetën] të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 2 (E drejta për jetën) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (ii) e detyrimeve të përcaktuara me paragrafin 4 të nenit 18 (Detyrimet e Përgjithshme), paragrafin 1 të nenit 50 (Reagim, parandalim dhe mbrojtje të menjëhershme), paragrafin 1 të nenit 51 (Vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i rrezikut) dhe paragrafin 1 të nenit 55 (Procedimet ex parte dhe ex officio) të Konventës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

Gjykata thekson se në rrethanat e rastit konkret, dhe të cilat janë detajisht të shtjelluara në Aktgjykimin e publikuar, bazuar në shkresat e lëndës, ishin zhvilluar dy kategori procedurash, sipas raportimeve përkatëse për dhunë në familje. E para, sipas rastit për dhunë në familje të raportuar më 10 nëntor 2019 dhe për të cilën procedurat përkatëse ishin zhvilluar nga Stacioni Policor, Prokuroria Themelore dhe Gjykata Themelore në Gjilan. Ndërsa e dyta, sipas rastit për dhunë në familje të raportuar më 3 mars 2021 dhe për të cilën procedura ishte zhvilluar në Stacionin Policor në Graçanicë dhe Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Përkitazi me kategorinë e parë të procedurave, bazuar në shkresat e lëndës, rezulton që procedura kishte filluar me lajmërimin e rastit për dhunë në familje më 10 nëntor 2019 në Stacionin Policor në Gjilan dhe kishte përfunduar me 27 janar 2020 me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan përmes të cilit, bashkëshorti i të ndjerës S.M., ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale të saktësuara paragrafin 1 të nenit 248 (Dhuna në Familje) dhe nënparagrafin 3.1 të nenit 184 (Sulmi) të Kodit Penal të Republikës së

Kosovës. Siç është sqaruar në Aktgjykimin e publikuar, përgjatë kësaj periudhe kohore, autoritetet respektive në Gjilan sipas kompetencave përkatëse kishin: (i) vendosur masën e paraburgimit; (ii) nxjerrë Urdhrin Mbrojtës në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajsh; (iii) parashtruar kallëzimin penal; (iv) ngritur aktakuzën; dhe (v) shpallur fajtor L.S.-në për veprat penale të saktësuara si më lart. Thënë këtë, Aktgjykimi i publikuar vë theks në faktin që Gjykata Themelore në Gjilan, kishte zëvendësuar dënimin me burg të L.S.-së në dënim me gjobë prej një mijë e treqind (1,300) euro. Urdhri përkatës i Mbrojtjes kishte skaduar më 26 nëntor 2020.

Përkitazi me kategorinë e dytë të procedurave, bazuar në shkresat e lëndës, rezulton që procedura kishte filluar me lajmërimin e rastit për dhunë në familje më 3 mars 2021 në Stacionin Policor në Graçanicë. Siç është sqaruar në Aktgjykimin e publikuar, bazuar në shkresat e lëndës, rezulton që të nesërmen: (i) ishte marrë deklarata e L.S.-së; dhe (ii) S.M.-së, dhe e cila sipas raportit përkatës të policisë, ndër të tjera, kishte theksuar që “nuk është interesuar që të vazhdoj me rastin”. Më 14 mars 2021, S.M., u privua nga jeta me armë zjarri nga L.S., i cili më pas kreu vetëvrasje.

Në kontekst të sqarimeve të lartcekura dhe bazuar në pretendimet e parashtrueses së kërkesës, Gjykata u fokusua në vlerësimin e përmbushjes së detyrimeve pozitive të shtetit përkitazi me kategorinë e dytë të procedurave, gjithnjë në kontekst edhe të kategorisë së parë. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht shtjelloi parimet e përgjithshme në kontekst të detyrimeve pozitive të shtetit që burojnë, ndër të tjera, nga neni 25 i Kushtetutës, neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe praktikës relevante gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas dhe Konventës së Stambollit.

Bazuar në parimet e lartcekura, dhe me theks në kriteret që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përfshirë Aktgjykimet në rastet Opuz kundër Turqisë, Kurt kundër Austrisë, X dhe Y kundër Bullgarisë dhe Landi kundër Italisë, Gjykata vlerësoi nëse autoritetet shtetërore, përkatësisht Stacioni Policor në Graçanicë dhe Prokuroria Themelore në Prishtinë: (i) kishin reaguan menjëherë; (ii) kishin bërë vlerësimin e mirëfilltë të rrezikut, dhe i cili, bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore, duhet të jetë autonom, proaktiv dhe gjithëpërfshirës; (iii) ishin në dijeni apo duhet të ishin në dijeni në lidhje me rrezikun e menjëhershëm dhe real për jetën e S.M.-së; dhe (iv) kishin ndërmarrë masa parandaluese për të mbrojtur apo parandaluar privimin nga jeta të S.M.-së.



Bazuar në vlerësimin e kritereve të lartcekura, Gjykata vë theks në faktin që: (i) zyrtarët policorë të Policisë në Graçanicë, kishin reaguar menjëherë duke dalë në vend të ngjarjes dhe marrë në intervistë të dyshuarin L.S., megjithatë të njëjtit, ndër të tjera, nuk kishin ndjekur hapat procedural të përcaktuar përmes Ligjit kundër Dhunës në Familje dhe Procedurave Standarde të Veprimit, duke anashkaluar edhe plotësimin e formave standarde përkitazi me vlerësimin e rrezikshmërisë dhe duke mos njoftuar Qendrën për Punë Sociale dhe Mbrojtësin e Viktimave, dhe të cilët sipas ligjit të lartcekur, do të kishin mundur të marrin hapa shtesë në mbrojtje të S.M.-së; ndërsa (ii) Prokuroria Themelore në Prishtinë, përgjatë një periudhe dhjetë (10) ditësh “ishte në fazën e grumbullimit të provave dhe informatave të nevojshme për ndriçimin e rrethanave faktike që nuk kanë qenë të njohura për organet përkatëse”, përkundër faktit që autoritet kompetente kishin të dhëna të sakta, pas raportimit të dhunës së 10 nëntorit 2019, përkitazi me L.S.-në, (i) ishte lëshuar një urdhër mbrojtës në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muajsh; dhe (ii) kishte një dënim për veprën penale të dhunës në familje dhe sulmit nga Gjykata Themelore në Gjiilan. Gjykata gjithashtu vuri theks në faktin se deklarimi i të ndjerës S.M. që “nuk kishte mundësi të paraqitej në polici dhe kishte kërkuar që L.S. të mos burgosej, por mundësisht të lirohej”, bazuar në detyrimet pozitive të shtetit të garantuara me nenin 25 të Kushtetutës në lidhje me nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenet 18, 50, 51 dhe 55 të Konventës së Stambollit, nuk e liron asnjë institucion shtetëror nga detyrimi për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme të përcaktuara me ligje dhe rregullativë të aplikueshme në mbrojtje të viktimës të dhunës në familje.

Pas vlerësimit përkatës për secilin kriter veç e veç, Gjykata konstatoi që në kundërshtim me garancitë e lartcekura kushtetuese, por edhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës, përfshirë Ligjin kundër Dhunës në Familje dhe Procedurat Standarde të Veprimit, por edhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, të gjitha autoritetet publike janë të detyruara të interpretojnë të drejtat dhe liritë themelore, autoritetet kompetente: (i) nuk kanë reaguar menjëherë; (ii) nuk kanë bërë një vlerësim të mirëfilltë të rrezikut, dhe i cili duhet të jetë autonom, proaktiv dhe i menjëhershëm; (iii) në rrethanat e rastit konkret, dhe marrë parasysh që L.S., tashmë ishte i dënuar paraprakisht për veprën penale të dhunës në familje, ishin në dijeni apo ishin dashur të jenë në dijeni në lidhje me rrezikun e menjëhershëm dhe real për jetën e S.M.-së; dhe (iv) nuk kishin ndërmarrë masa parandaluese për të mbrojtur apo parandaluar

privimin nga jeta të S.M.-së.

Në fund dhe përkitazi me efektin e këtij Aktgjykimi, ky i fundit, vuri theks në faktin që Gjykata nuk ka autorizime ligjore për të caktuar kompensim të dëmit për rastet kur konstaton shkelje të dispozitave respektive kushtetuese, por sqaroi që parashtruesja e kërkesës ka të drejtën për të shfrytëzuar mjetet e tjera juridike në dispozicion për realizimin e mëtejshëm të të drejtave për kompensimin përkatës në përputhje me gjetjet e këtij Aktgjykimi.

Në fund, duhet të theksohet që përtej Aktgjykimit të publikuar sot, dhe i cili saktëson detyrimet e shtetit në kontekst të dhunës në familje dhe mbrojtjes së të drejtës në jetë, bazuar në garancitë kushtetuese, por edhe instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës, përfshirë parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Gjykata gjithashtu përmes Aktgjykimit në rastin KI41/12, me parashtrues Gëzim dhe Makfire Kastrati, të publikuar më 26 shkurt 2013, kishte konstatuar shkelje të nenit 25 të Kushtetutës dhe nenit 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përfshirë shkelje të neneve 32 [E drejta në Mjet Juridik] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Ky Aktgjykim i vitit 2013, gjithashtu kishte vënë theks në detyrimet e autoriteteve shtetërore në kontekst të ndërmarrjes së masave të nevojshme kundër dhunës në familje dhe mbrojtjes së të drejtës në jetë. Për më tepër, Gjykata rikujton që Konventa e Stambollit është drejtpërdrejtë e aplikueshme në Republikën e Kosovës që nga miratimi i amendamenteve kushtetuese më 25 shtator 2020. Kjo e fundit, përfshin edhe detyrimin e shtetit, përkatësisht Republikës së Kosovës, për të përcaktuar mjete juridike efektive dhe kompensim adekuat për viktimat e dhunës në familje në rast të dështimit të shtetit për të përmbushur detyrimet përkatëse në këtë kontekst.



Aktgjykim

KO 100/22 & KO 101/22

Parashtrues

Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë dhe Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, ka vendosur lidhur me kërkesat e bashkuara në rastet KO 100/22, me parashtrues: Abelard Tahiri dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë dhe KO 101/22, me parashtrues: Arben Gashi dhe dhjetë (10) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Gjykata njëzëri ka vendosur që të (i) deklarojë kërkesat e pranueshme dhe të konstatojë që: (ii) pika 1.3.2 e paragrafit 1 të nenit 6 dhe neni 8, përkatësisht neni 10/A i Ligjit të kontestuar, nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], paragrafin 10 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] dhe nenin 132 [Roli dhe Kompetencat e Avokatit të Popullit] të Kushtetutës; (iii) paragrafi 2/a i nenit 13 të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit] dhe paragrafin 1 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës; (iv) paragrafi 5 i nenit 16 të Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës; (v) neni 18, përkatësisht 23/A i Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me nenet 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës; (vi) paragrafi 3 i nenit 11 dhe neni 20 i Ligjit të kontestuar

nuk janë në përputhshmëri me paragrafin 1 të nenit 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe paragrafin 1 të nenit 110 [Këshilli Prokurorial i Kosovës] të Kushtetutës; dhe (vii) të shpallë të pavlefshëm, në tërësinë e tij, Ligjin nr.08/L-136 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Thelbi i pretendimeve të parashtruesve të kërkesave, të mbështetura edhe nga Këshilli Prokurorial, Oda e Avokatëve por, në esencë, edhe nga Avokati i Popullit sa i përket çështjeve që ndërlidhen me kompetencat e tij dhe të kundërshtuara nga Ministria e Drejtësisë, ndërlidhet me cenimin e pavarësisë kushtetuese të Këshillit Prokurorial dhe ndarjen e balancin e pushteteve, në kundërshtim me garancitë e nenit 4 dhe nenit 110 të Kushtetutës, respektivisht, sepse Ligji i kontestuar, sipas parashtruesve të kërkesës, ndër tjerash: (i) ndryshon përbërjen e Këshillit Prokurorial, duke e zvogëluar proporcionin në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë, me këta të fundit, të zgjedhur me votën e shumicës së thjeshtë të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë në Kuvend, duke e nënshtruar zgjedhjen e anëtarëve të një institucioni të pavarur kushtetues vetëm në vullnetin e shumicës qeverisëse të përfaqësuar në Kuvend; (ii) përcakton kompetencën e Avokatit të Popullit për të zgjedhur një (1) nga anëtarët jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, në kundërshtim me Kushtetutën dhe funksionet kushtetuese të Avokatit të Popullit; (iii) duke e përcaktuar shumicën vendimmarrëse të Këshillit Prokurorial në shumicë të kualifikuar dhe duke e kushtëzuar të njëjtën nga vota e anëtarëve jo-prokurorë të tij të zgjedhur me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, e nënshtron vendimmarrjen e një institucioni të pavarur kushtetues ndaj vullnetit politik të shumicës qeverisëse të përfaqësuar në Kuvend; (iv) nuk trajton në mënyrë të barabartë anëtarët prokurorë dhe jo-prokurorë në kontekst të mjetit juridik në dispozicion në rast të shkarkimit të tyre, duke u mundësuar ankesën e drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme vetëm anëtarëve prokurorë të Këshillit; dhe (v) ndërprejnë në mënyrë arbitrare mandatet e anëtarëve të Këshillit Prokurorial, në kundërshtim me garancitë kushtetuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Gjykata fillimisht dhe ndër tjerash, ka shtjelluar: (i) parimet themelore kushtetuese lidhur me sistemin e drejtësisë, siç janë të saktësuara me Kushtetutë; (ii) historikun e shkurtër të Këshillit Prokurorial, përmes ligjeve respektive që nga themelimi i tij, për aq sa është relevante për rrethanat



e rastit konkret; dhe (iii) praktikën relevante gjyqësore të Gjykatës, të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE). Gjykata gjithashtu ka shtjelluar parimet themelore që burojnë nga Raportet dhe Opinionet e Komisionit të Venecias, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në: (i) Përmbledhjen e Opinioneve dhe Raporteve lidhur me Prokurorët të 26 prillit 2022; (ii) Raportin mbi Standardet Evropiane lidhur me Pavarësinë e Sistemit Gjyqësor: Pjesa II – “Shërbimi i Prokurorisë”; (iii) Opinionin lidhur me shumicat e kualifikuara dhe mekanizmat përkatës de-blokues; (iv) Opinionet relevante të Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropian, përfshirë Opinionet nr. 9 (2014) dhe nr. 13 (2018), si dhe Rekomandimet relevante të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës; dhe (v) dy Opinionet e Komisionit të Venecias për Kosovën, lidhur me Ligjin e kontestuar, të miratuara më 13 dhjetor 2021 dhe 23 mars 2022, respektivisht.

Në aplikimin e parimeve të lartcekura në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Aktgjykimi fillimisht (i) thekson që bazuar në nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës] të Kushtetutës, pushteti qeverisës buron nga Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës, në pajtim me të cilën duhet të jenë ligjet dhe aktet tjera juridike; dhe (ii) rithekson praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, bazuar në të cilën, Kushtetuta përbëhet nga një tërësi e parimeve dhe vlerave kushtetuese, mbi bazën e të cilave është ndërtuar dhe duhet të funksionojë Republika e Kosovës, dhe se normat e përcaktuara me Kushtetutë nuk mund të interpretohen të izoluara nga njëra tjetra, por duhet të lexohen në ndërlidhje me njëra tjetrën, ngase vetëm në atë mënyrë nxirret kuptimi i saktë i tyre në kontekst të nenit 7 [Vlerat] të Kushtetutës lidhur me vlerat e Republikës së Kosovës.

Më tej, Aktgjykimi gjithashtu sqaron që bazuar në Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, por edhe ato të Këshillit Konsultativ të Prokurorëve Evropian dhe rekomandimet relevante të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, ndër tjerash, rezulton që (i) për dallim prej sistemeve gjyqësore, standardet në kontekst të organizimit të sistemeve prokuroriale, janë më pak të konsoliduara/uniforme; megjithatë, (ii) ekziston një tendencë e përhapur drejt pavarësisë së sistemeve prokuroriale, dhe praktika gjyqësore e GJEDNJ-së por edhe e GJDBE-së gjithashtu, vënë theks në këtë aspekt.

Thënë këtë, Aktgjykimi sqaron që në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, sistemi prokurorial është plotësisht i pavarur. Më saktësisht, Këshilli Prokurorial është pjesë përbërëse e Kapitullit VII të Kushtetutës lidhur me Sistemin e Drejtësisë dhe bashkë me Këshillin Gjyqësor, kanë kompetencën e

administrimit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, respektivisht dhe pavarësisht ngjashmërive e dallimeve përkatëse, në ushtrimin e funksioneve të tyre, Kushtetuta u akordon të dyjave “pavarësi të plotë kushtetuese”. Aktgjykimi sqaron që kjo pavarësi e plotë kushtetuese, bazuar në nenin 4 të Kushtetutës lidhur me ndarjen dhe balancimin e pushteteve, i nënshtrohet edhe balancimit e ndërveprimit me pushtetet tjera, gjithnjë në përputhje me vlerat demokratike siç janë të përcaktuara në nenin 7 të Kushtetutës.

Nga leximi i përbashkët i dispozitave kushtetuese dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, në parim, dhe në kontekst të Këshillit Prokurorial, është i rëndësishëm ndërveprimi i Këshillit Prokurorial me Kuvendin, sipas përcaktimeve të neneve 65 dhe 110 të Kushtetutës. Ndërveprimi i këtyre dispozitave, në esencë, përcakton ushtrimin e kompetencës së Kuvendit për të përcaktuar përbërjen e Këshillit Prokurorial dhe për të zgjedhur anëtarët e Këshillit, megjithatë gjithnjë në funksion të ruajtjes së pavarësisë së plotë të Këshillit Prokurorial në ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës; dhe njëkohësisht, të respektimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 4 të Kushtetutës.

Në Aktgjykimin e Gjykatës, parimet e përmbledhura më lart, janë aplikuar në shqyrtimin e secilit nen të vlerësuar të Ligjit të kontestuar veç e veç. Thënë këtë dhe për qëllime të kësaj përmbledhje, Gjykata do të sqarojë të gjeturat dhe konstatimet kryesore përkitazi me çështjet më kontestuese të Ligjit të kontestuar, përkatësisht: (i) përbërjen e ndryshuar të Këshillit Prokurorial dhe proporcionin në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë; (ii) zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë përmes shumicës së votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë në Kuvend; (iii) kompetencën e Avokatit të Popullit për të caktuar, përkatësisht zgjedhur një (1) anëtar jo-prokuror të Këshillit Prokurorial; (iv) dallimin në trajtim në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë lidhur me të drejtën në mjet juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave, në rast të vendimit për shkarkimin e tyre si anëtarë të Këshillit Prokurorial; dhe (v) ndërprerjen e mandateve ekzistuese të anëtarëve të Këshillit Prokurorial pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar.

(i) Balanci i anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë në Këshillin Prokurorial

Aktgjykimi sqaron që Ligji i kontestuar përcakton që Këshilli Prokurorial përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, përfshirë Kryeprokurorin i cili përfaqësohet në Këshill sipas detyrës zyrtare, tre (3) anëtarë prokurorë të

përzgjedhur nga sistemi prokurorial dhe tre (3) anëtarë jo-prokurorë, për dallim nga Ligji bazik sipas të cilit, Këshilli Prokurorial përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, përkatësisht Kryeprokurori i cili përfaqësohet sipas detyrës zyrtare, nëntë (9) anëtarë prokurorë të përzgjedhur nga sistemi prokurorial dhe tre (3) anëtarë jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi, sipas propozimeve të Odës së Avokatëve dhe Fakulteteve Juridike dhe konkursit publik lidhur me një (1) anëtar të shoqërisë civile, sipas specifikave të ligjit të aplikueshëm.

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitës së Ligjit të kontestuar që përcakton strukturën e lartcekur, Aktgjykimi sqaron që Kushtetuta përmban dy nene përcaktuese, nenin 65 dhe 110 të Kushtetutës, respektivisht. Kushtetuta, përmes paragrafit 4 të nenit 110 të saj ka përcaktuar, ndër tjerash, që përbërja e Këshillit Prokurorial rregullohet me ligj, ndërsa përmes paragrafit 10 të nenit 65 të saj, ka përcaktuar, ndër tjerash, që anëtarët e Këshillit Prokurorial i zgjedh Kuvendi në pajtim me Kushtetutën. Për dallim prej Këshillit Gjyqësor, në rastin e Këshillit Prokurorial, Kushtetuta nuk përcakton raportin në mes të anëtarëve të përzgjedhur nga vet sistemi prokurorial dhe anëtarëve jo-prokurorë përkatës, duke e deleguar rregullimin e këtij proporcioni në nivel ligji, gjithnjë për aq sa nuk cenohet pavarësia e plotë kushtetuese e Këshillit Prokurorial, siç është e përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës. Marrë parasysh mungesën e rregullimit specifik kushtetues në kontekst të proporcionit në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, Aktgjykimi i referohet edhe Opinioneve të Komisionit të Venecias, përfshirë dy Opinioneve për Kosovën, të cilat, ndër tjerash, theksojnë që është më rëndësi që përbërja e këshillave prokurorial të shmang dy rreziqe, përkatësisht: (i) në kontekst të anëtarëve prokurorë, tendencën e “korporatizimit” apo perceptimit të tillë, duke marrë parasysh “organizimin hierarkik të sistemit prokurorial dhe kulturës së subordinimit”; dhe njëkohësisht, (ii) në kontekst të anëtarëve jo-prokurorë, mundësinë e “politizimit” të Këshillit, përkatësisht ndikimit politik përmes mënyrës së zgjedhjes së tyre. Ky balancim, në parim, dhe ndër tjerash, sipas Opinioneve të lartcekura, mund të arrihet përmes një përbërje pluraliste të Këshillit në të cilën prokurorët e përzgjedhur nga vet sistemi përbëjnë “pjesë substanciale”, por jo detyrimisht shumicën e anëtarëve të Këshillit dhe e cila eviton mundësinë që prokurorët të qeverisin të vetëm, por në të njëjtën kohë, pamundëson që anëtarët jo-prokurorë të mund t’i bllokojnë apo “mbivotojnë lehtë ata”. Bazuar në sqarimet e përmbledhura më sipër dhe marrë parasysh faktin që

(i) sipas paragrafit 4 të nenit 110 të Kushtetutës, ndër tjerash, përbërja e Këshillit Prokurorial rregullohet me ligj; dhe (ii) standardet e Komisionit të Venecias reflektojnë rëndësinë e Këshillave Prokurorial të balancuar në mes të anëtarëve prokurorë të përzgjedhur nga vet sistemi dhe atyre jo-prokurorë, gjithnjë me garancitë e nevojshme për të shmangur rrezikun e “korporatizimit” por edhe “politizimit” të Këshillit, Gjykata konstatoi që përbërja, përkatësisht proporcioni në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën.

(ii) Shumica e nevojshme në Kuvend për zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial

Për sa i përket shumicës së nevojshme për zgjedhjen e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial nga Kuvendi, Aktgjykimi vë theks në dy dispozita përcaktuese, nenin 65 dhe 80 të Kushtetutës, respektivisht. Neni 65 i Kushtetutës, në paragrafin 10 të tij përcakton që anëtarët e Këshillit Prokurorial zgjedhen nga Kuvendi në pajtim me Kushtetutën, ndërsa neni 80 i Kushtetutës, në paragrafin 1 të tij, përcakton që ligjet, vendimet dhe aktet tjera miratohen nga Kuvendi me shumicën e votave të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, përveç në rastet kur është ndryshe e përcaktuar me Kushtetutë.

Zgjedhja e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial nga Kuvendi, marrë parasysh që Kushtetuta nuk ka përcaktuar ndryshe, bie në kuadër të fushëveprimit të paragrafit 1 të nenit 80 të Kushtetutës. Për pasojë dhe në mungesë të një rregullimi tjetër specifik në Kushtetutë, Aktgjykimi sqaron që zgjedhja e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial me shumicë të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, nuk është në kundërshtim me Kushtetutën.

Thënë këtë dhe marrë parasysh paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës lidhur me pavarësinë e plotë kushtetuese të Këshillit Prokurorial dhe në kontekst të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve siç janë përcaktuar në nenet 4 dhe 7 të Kushtetutës, respektivisht, Aktgjykimi gjithashtu vë theks në faktin që (i) Raportet dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, përfshirë edhe Opinionet për Kosovën lidhur me Ligjin e kontestuar, theksojnë që preferohet që zgjedhja e anëtarëve jo-prokurorë të këshillave prokurorial, të bëhet me shumicë të kualifikuar dhe jo me shumicë të thjeshtë, duke theksuar edhe mundësinë e përcaktimit të mekanizmave pasues deblokues apo edhe sistemeve proporcionale të votimit, në mënyrë që e njëjta shumicë parlamentare të mos ketë mundësinë që të zgjedh njëkohësisht dhe me

shumicë të thjeshtë anëtarët jo-prokurorë të Këshillit, duke rezultuar kështu në mundësinë e politizimit të Këshillit dhe cenimin e pavarësisë së tij; dhe (ii) ligjet e Republikës së Kosovës, përfshirë ato për Këshillin Prokurorial, por dhe Këshillin Gjyqësor, ndër vite, kanë përcaktuar edhe shumica më të larta për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të tyre, duke përfshirë edhe shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

(iii) Kompetenca e Avokatit të Popullit për të zgjedhur anëtarë jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial

Në kontekst të dispozitave përkatëse të Ligjit të kontestuar përmes të cilit Avokatit të Popullit i përcaktohet kompetenca për të caktuar/zgjedhur dhe shkarkuar një (1) anëtar jo-prokuror të Këshillit Prokurorial, Aktgjykimi së pari vë theks në faktin që sipas Opinioneve të Komisionit të Venecias, (i) në përcaktimin e proporcionit të duhur në mes të anëtarëve prokurorë të përzgjedhur nga sistemi prokurorial dhe atyre jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi, një numër anëtarësh mund të përfaqësojnë edhe institucione të pavarura dhe/ose shoqërinë civile; dhe (ii) në përbërje të këshillave prokurorial, të njëjtat mund të përfaqësohen edhe sipas detyrës zyrtare apo përmes propozimit/nominimit të kandidatëve përkatës. Një kombinim i tillë mekanizmash, reflektohet ndër tjera, edhe në Ligjin bazik për Këshillin Prokurorial, i cili përfshin mekanizmin e përfaqësimit sipas detyrës zyrtare në Këshill të Kryeprokurorit të Shtetit dhe rolin e Odës së Avokatëve, Fakulteteve Juridike dhe shoqërisë civile në propozimin/nominimin e anëtarëve jo-prokurorë të Këshillit dhe të zgjedhur më pas nga Kuvendi.

Thënë këtë, Aktgjykimi, ndër tjerash, sqaron që pikënisja e vlerësimit të kompetencës së Avokatit të Popullit për të caktuar/zgjedhur por edhe shkarkuar njërin nga anëtarët jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, është Kushtetuta, përkatësisht (i) paragrafi 10 i nenit 65 të Kushtetutës, sipas të cilit e ndër tjerash, Kuvendi zgjedh anëtarët e Këshillit Prokurorial; (ii) kompetencat kushtetuese të Kuvendit për të zgjedhur bartësit e funksioneve të institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara në Kapitull VII dhe XII të Kushtetutës, respektivisht; dhe (iii) neni 132 i Kushtetutës, sipas të cilit, dhe ndër tjerash, Avokati i Popullit, ka kompetenca për të mbikëqyrur të gjitha autoritetet publike, përfshirë Këshillin Prokurorial, në kontekst të veprimeve e mosveprimeve të paligjshme lidhur me të drejtat dhe liritë themelore. Në aspekt të kësaj të fundit, Aktgjykimi gjithashtu rikujton që përderisa Opinioni i Komisionit të Venecias, kishte sqaruar që përfshirja e Avokatit të Popullit në përbërjen e Këshillit Prokurorial, jo

detyrimisht është në kundërshtim me standardet, gjithashtu kishte tërhequr vëmendjen që një përfshirje e tillë “të mos e dëmtojë aftësinë e tij apo saj [Avokatit të Popullit] që të bëjë përcaktime të pavarura lidhur me çështjet që ndërlidhen me KPK-në”.

Në kontekst të dispozitave të lartcekura në tërësinë e tyre, Aktgjykimi së pari sqaron që përderisa në rastin e Këshillit Prokurorial, për dallim nga Këshilli Gjyqësor, përcaktimi i përbërjes dhe mënyrës së zgjedhjes/emërimit të anëtarëve përkatës është ndarë në mes të Kushtetutës dhe ligjit, kompetenca e Kuvendit për të zgjedhur anëtarët përkatës të Këshillit Prokurorial është e përcaktuar me Kushtetutë dhe për pasojë, bazuar në parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e Gjykatës, nuk mund të bartet në institucionin e Avokatit të Popullit përmes ligjit të miratuar sipas paragrafit 4 të nenit 110 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë dhe së dyti, Aktgjykimi sqaron që në kontekst të të gjitha institucioneve të pavarura kushtetuese të përcaktuara me Kapitullin VII lidhur me Sistemin e Drejtësisë dhe Kapitullin XII lidhur me Institucionet e Pavarura, dhe pavarësisht nëse Kushtetuta (i) e ka specifikuar kompetencën e Kuvendit për të zgjedhur/emëruar në nivel të Kushtetutës; apo (ii) ka saktësuar që mënyra e zgjedhjes/emërimit rregullohet në nivel ligji, bartësit e funksioneve të institucioneve të pavarura kushtetuese, zgjedhen nga Kuvendi, me përjashtim të anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përbërja e të cilit është e përcaktuar në Kushtetutë. Ky është rasti me anëtarët e saktësuar të Këshillit Gjyqësor, Avokatin e Popullit, zëvendës Avokatët e Popullit, Auditorin e Përgjithshëm, Guvernatorin e anëtarët e Bordit të Bankës Qendrore dhe anëtarët e Komisionit të Pavarur të Medie, e të cilët zgjedhen nga Kuvendi në mënyrën e saktësuar në Kushtetutë dhe/ose ligjet përkatëse. Së treti, bazuar në nenin 132 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka kompetenca kushtetuese të mbikëqyrjes, përkatësisht dhe ndër tjerash, (i) mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, përfshirë ato të Këshillit Prokurorial; dhe (ii) ka detyrimin të mos pranojë udhëzime e ndërhyrje nga asnjë autoritet që ushtron pushtet në Republikën e Kosovës dhe të njëjtit janë të detyruar t'i përgjigjen kërkesave të tij/saj. Bazuar në këto karakteristika kushtetuese, Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes ligjeve përkatëse, i ka përcaktuar Avokatit të Popullit, autorizime të theksuara, përfshirë funksione të mbikëqyrjes, në kontekst të procedurave disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, që administrohen nga Këshillat përkatës. Në fakt dhe marrë parasysh natyrën e funksioneve kushtetuese të Avokatit të Popullit, të njëjtit, ligjvënësi nuk ia ka akorduar as

kompetencën për të caktuar/zgjedhur zëvendësit e tij/saj, e të cilët i zgjedh Kuvendi me shumicën e deputetëve të pranishëm dhe që votojnë. Për pasojë, Aktgjykimi sqaron që kompetenca e Avokatit të Popullit për të zgjedhur anëtarë jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën.

(iv) Shumica vendimmarrëse në Këshillin Prokurorial

Për sa i përket mënyrës së vendimmarrjes në Këshill Prokurorial, Aktgjykimi fillimisht sqaron që neni 110 i Kushtetutës ka dy paragrafë përcaktues, paragrafin 4 të nenit 110 të Kushtetutës, sipas të cilit, ndër tjerash, rregullat e procedurës së Këshillit përcaktohen me ligj të miratuar nga Kuvendi; dhe paragrafin 1 të nenit 110 të Kushtetutës, sipas të cilit, Këshilli ka pavarësi të plotë në ushtrimin e kompetencave kushtetuese. Në kontekst të kësaj të fundit, Aktgjykimi gjithashtu rikujton që bazuar në Opinionet e referuara të Komisionit të Venecias, por edhe në praktikën e saj gjyqësore, mënyra e vendimmarrjes së institucioneve të pavarura kushtetuese është esenciale në përmbushjen e pavarur të funksioneve të tyre.

Aktgjykimi më tej sqaron që, dispozita përkatëse e cila përcakton mënyrën e vendimmarrjes, saktëson që vendimet në Këshill merren me pesë (5) vota, përkatësisht shumicën e kualifikuar prej dy të tretash (2/3) në një përbërje prej shtatë (7) anëtarësh, me kushtin që në këtë shumicë të jenë edhe dy (2) vota të anëtarëve jo-prokurorë. Pas vërejtjes së Opinionit të Komisionit të Venecias lidhur me mundësinë e bllokimit të vendimmarrjes dhe rrjedhimisht rekomandimit të përfshirjes së një mekanizimi de-blokues të vendimmarrjes, Ligji i kontestuar është plotësuar në Kuvend, duke e shtuar radhën e dytë të votimit, duke përcaktuar sërish shumicën vendimmarrëse prej dy të tretash (2/3) të anëtarëve të Këshillit, që nënkupton votën e të paktën një (1) anëtari jo-prokuror të Këshillit të zgjedhur me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi.

Në kontekst të vlerësimit kushtetues të kësaj dispozite të Ligjit të kontestuar dhe nëse e njëjta cenon pavarësinë e plotë kushtetuese të Këshillit, Aktgjykimi thekson që është e rëndësishme të merren parasysh (i) natyra e çështjeve që i nënshtrohet një vendimmarrjeje të tillë; dhe (ii) përbërja e Këshillit Prokurorial, përfshirë mënyra e zgjedhjes së anëtarëve jo-prokurorë të tij.

Lidhur me çështjen e parë, Aktgjykimi sqaron që vendimmarrja e Këshillit që i nënshtrohet shumicës së kualifikuar prej dy të tretash (2/3) në dy radhë të votimit, ndër tjerash, ndërldhet me funksionet më thelbësore të Këshillit Prokurorial, në ushtrimin e të cilave i njëjti ka pavarësi të plotë kushtetuese, të

përcaktuara me nenet 109 dhe 110 të Kushtetutës, përkritazi me (i) propozimin e Kryeprokurorit të Shtetit; dhe miratimin e akteve lidhur me (ii) rekrutimin, propozimin, avancimin, transferimin dhe disiplinimin e prokurorëve. Ndërsa, lidhur me çështjen e dytë, Aktgjykimi sqaron që (i) në kontekst të konstatimit të Gjykatës që kompetenca e Avokatit të Popullit për të caktuar/zgjedhur një (1) anëtar të Këshillit nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën; dhe (ii) duke marrë parasysh përcaktimin e Ligjit të kontestuar që anëtarët jo-prokurorë të Këshillit të zgjedhen njëkohësisht dhe me shumicë të thjeshtë në Kuvend, rezulton që vendimmarrja në Këshill Prokurorial lidhur me funksionet kushtetuese më thelbësore të tij, do të mund të kushtëzohej nga vota e njërit nga anëtarët jo-prokurorë të zgjedhur nga Kuvendi me shumicë të thjeshtë. Gjykata thekson që një zgjidhje e tillë, nuk është as në përputhje me Opinionet e Komisionit të Venecias, as me pavarësinë kushtetuese të garantuar për Këshillin sipas paragrafit 1 të nenit 110 të Kushtetutës, as me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve në një shtet demokratik. Për pasojë, Aktgjykimi sqaron që mënyra e përcaktuar e vendimmarrjes së Këshillit sipas Ligjit të kontestuar nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën.

Thënë këtë, duke ju referuar edhe Opinioneve të Komisionit të Venecias, Aktgjykimi gjithashtu vë në pah që në kontekst të përbërjes së saktësuar të Këshillit përmes Ligjit të kontestuar, edhe shumica e thjeshtë, por edhe ajo e kualifikuar, kanë mangësitë e tyre, sepse (i) në rast të votimit me shumicë të thjeshtë, do t'u mundësohej anëtarëve prokurorë që të qeverisin të vetëm dhe një zgjidhje e tillë do të mund të cenonte edhe esencën e parimit që Këshillat duhet të kenë përbërje pluraliste; ndërsa, (ii) në rast të votimit me shumicë të kualifikuar dhe pa mekanizëm kuptimplotë e efektiv de-blokimi, do t'u mundësohej anëtarëve jo-prokurorë të zgjedhur njëkohësisht dhe me shumicë të thjeshtë nga Kuvendi, që potencialisht të bllokojnë çdo vendimmarrje. Në këtë kontekst, Aktgjykimi vë në pah parimet e Komisionit të Venecias, lidhur me mundësitë e përbërjeve të këshillave prokurorial, përfshirë balancimin në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë dhe mënyrën e zgjedhjes së këtyre të fundit.

(v) Dallimi në trajtim lidhur me mjetin juridik dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave

Për sa i përket të drejtës në mjetin juridik dhe mbrojtjes gjyqësore të të drejtave për anëtarët e Këshillit Prokurorial në rast të shkarkimit të tyre, Aktgjykimi fillimisht sqaron që nenet 24, 32 dhe 54 të Kushtetutës duhet të interpretohen në kontekst të

paragrafit 1 të nenit 110 të Kushtetutës, përkatësisht pavarësisë së plotë të Këshillit në ushtrimin e funksioneve të tij. Aktgjykimi vë theks në faktin që pavarësia e Këshillit është e ndërlidhur me pavarësinë e anëtarëve përkatës dhe mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimit të anëtarëve të tij, është thelbësore në këtë aspekt. Aktgjykimi vëren që kjo çështje nuk ishte objekt shqyrtimi i dy Opinioneve të Komisionit të Venecias lidhur me Ligjin e kontestuar.

Aktgjykimi më tej sqaron që Ligji i kontestuar, për dallim nga ligjet paraprake, përcakton dallim në trajtim në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë të Këshillit Prokurorial, sa i përket mjetit juridik në dispozicion në rast të shkarkimit të tyre. Aktgjykimi gjithashtu sqaron që sipas Ligjit të kontestuar, (i) anëtarët prokurorë të Këshillit shkarkohen pas votimit me shumicë prej dy të tretash (2/3) në Këshill dhe më pas kanë të drejtën e ankesës drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, e cila merr vendim brenda tridhjetë (30) ditësh; ndërsa (ii) kolegët e tyre jo-prokurorë, pas propozimit të Këshillit, shkarkohen nga Kuvendi, me shumicën e thjeshtë të deputetëve të pranishëm dhe që votojnë, për dallim nga shumica e të gjithë deputetëve të Kuvendit përcaktuar me Ligjin bazik, dhe nuk e kanë të drejtën e ankesës së drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme. Në aplikimin e parimeve që burojnë nga praktika gjyqësore e saj dhe ajo e GJEDNJ-së në këtë kontekst, Gjykata konstatoi që përderisa një mjet juridik, përkatësisht procedura e konfliktit administrativ në Gjykatën Themelore, ekziston edhe për anëtarët jo-prokurorë, dallimi në trajtim në mes anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë përkitazi me mjetin juridik përkatës dhe mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën.

(vi) Ndërprerja e mandateve të një institucioni të pavarur kushtetues përmes ligjit

Për sa i përket ndërprerjes së mandateve të anëtarëve të Këshillit, përkatësisht ndërprerjes së mandateve ekzistuese dhe pa të drejtë në mjete juridike (i) për gjashtë (6) nga nëntë (9) anëtarët prokurorë përmes shortit; dhe (ii) anëtarëve jo-prokurorë përmes ligjit, Aktgjykimi fillimisht sqaron që Kushtetuta ka dy nene përcaktuese, nenin 4 dhe nenin 110 të Kushtetutës, respektivisht. I pari, në paragrafin 1 të tij, përcakton që Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me Kushtetutë, ndërsa i dyti, (i) në paragrafin 1 të tij përcakton që Këshilli Prokurorial është institucion plotësisht i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij në pajtim me ligjin; dhe (ii) në paragrafin 4 të tij përcakton që përbërja e Këshillit Prokurorial, përfshirë

dispozitat për mandatin, rregullohen me ligj.

Në kontekst të sigurisë së mandateve të anëtarëve të institucioneve të pavarura kushtetuese, Aktgjykimi fillimisht sqaron (i) praktikën përkatëse gjyqësore të Gjykatës; dhe më pas (ii) praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe GJDBE-së. Lidhur me të parën, Gjykata ka mbajtur qëndrimin që ndërprerja e parakohshme e mandateve kushtetuese dhe/ose mandateve ligjore të institucioneve të pavarura kushtetuese, i nënshtrohet vetëm kushteve të përcaktuara në Kushtetutë dhe/ose ligje mbi të cilat mandatet përkatëse janë fituar.

Një qëndrim i tillë, në parim, është mbajtur edhe nga GJEDNJ dhe GJDBE, ndër tjerash, përmes rasteve Baka kundër Hungarisë, Grzeda kundër Polonisë, C-619/18, Komisioni Evropian kundër Polonisë dhe C-192/18, Komisioni Evropian kundër Polonisë, respektivisht. Në kontekst të këtyre aktgjykimeve dhe gjithnjë duke marrë parasysh edhe dallimet dhe ngjashmëritë në mes tyre, në parim rezulton që (i) ndërprerja e parakohshme e mandateve në të gjitha rastet, pasonte, ndër tjerash, si rezultat i miratimit të ligjeve të reja në emër të reformave në sistemin e drejtësisë dhe GJEDNJ e GJDBE, në konstatimin e shkeljeve të Konventës Evropiane dhe të së drejtës së Bashkimit Evropian, respektivisht, nuk kishin marrë parasysh argumentet e qeverive përkatëse që ruajtja e mandateve ekzistuese do të përbënte pengesë për reformat e planifikuara; (ii) siguria e mandateve kushtetuese dhe ligjore është esenciale për pavarësinë e institucioneve të pavarura, dhe ndërprerja e parakohshme e tyre mund të bëhet vetëm bazuar në dispozitat dhe procedurat përkatëse të saktësuara mbi kushtetutat dhe/ose ligjet mbi bazën e të cilave janë fituar; (iii) ekzistenca e mjeteve efektive juridike për të kontestuar vendimet përkatëse bazuar në të cilat mandatet janë ndërprerë në mënyrë të parakohshme është e rëndësishme dhe mungesa e tyre kishte rezultuar në shkelje të Konventës Evropiane në rastet e lartcekura të GJEDNJ-së; dhe (iv) përjashtimisht, mandatet e fituara mund të ndërpriten në mënyrë të parakohshme, megjithatë çdo iniciativë/reformë ligjore e cila mund të rezultojë në ndërprerje të mandateve përkatëse, duhet të ndjek një qëllim legjitim dhe të jetë proporcionale me qëllimin e ndjekur, dhe në këtë kontekst, ndër tjerash, praktika e lartcekur gjyqësore, me theks në rastin Grzeda, gjithashtu merr parasysh qasjen e ligjbërësit ndaj sigurisë së mandateve përgjatë ekzistencës së institucioneve përkatëse.

Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, siç është sqaruar në Aktgjykim, në parim, gjithashtu mbajnë të njëjtin qëndrim. Të njëjtat theksojnë rëndësinë e ruajtjes së mandateve të anëtarëve të



institucioneve kushtetuese, pa marrë parasysh nëse të njëjtat janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe/ose ligj. Në parim, dhe sipas Komisionit të Venecias, përfundimi i parakohshëm i mandateve duhet të jetë gjithmonë i lidhur me një shkelje të identifikueshme ose dështim në kryerjen e detyrës të anëtarit përkatës dhe të ndjek bazën, përfshirë procedurën kushtetuese/ligjore për shkarkim apo përfundim të mandatit sipas së cilës janë fituar sepse në të kundërtën dhe ndër tjerash, ndërprerja e mandateve të institucioneve kushtetuese, do të mund të varej në vazhdimësi nga preferencat e pushtetit ekzekutiv dhe/ose legjislativ.

Thënë këtë, dy Opinionet e Venecias lidhur me Ligjin e kontestuar, në këtë kontekst dhe ndër tjerash, theksojnë që (i) dispozitat e Ligjit të kontestuar të cilat mundësojnë vazhdimin e mandateve të një pjese të anëtarësisë së anëtarëve të Këshillit Prokurorial, janë “më të respektueshme” ndaj standardeve ndërkombëtare në raport me modelin paraprak të Ligjit të kontestuar, i cili kishte propozuar ndërprerjen e përnjëhershme të të gjitha mandateve të Këshillit Prokurorial; dhe (ii) anëtarët e Këshillit Prokurorial, në parim, duhet të lejohen të përfundojnë mandatin e tyre, por përjashtimisht, ndërprerja e mandateve mund të jetë e pranueshme, nëse rezulton në “përmirësim të dukshëm të sistemit aktual” dhe atë nëse “Qeveria demonstroi bindshëm se zëvendësimi i tyre i shërben një interesi jetik publik dhe çon në përgjithësi në përmirësim të sistemit”.

Në këtë kontekst, Aktgjykimi sqaron që përmirësimi i balancimit në mes të anëtarëve prokurorë dhe jo-prokurorë në Këshillin Prokurorial, në parim, kontribuon në avancimin e legjitimitetit demokratik të të njëjtit, gjithnjë nëse është pasuar me mekanizmat e nevojshëm për të siguruar pavarësinë e plotë të tij. Megjithatë, dhe me kujdes të theksuar në parimet e lartcekura, dhe duke marrë parasysh që (i) praktika gjyqësore e Gjykatës, në mënyrë konsistente ka theksuar që ndërprerja e mandateve të anëtarëve të një institucioni të pavarur kushtetues, duhet të jetë e ndërlidhur me bazat e përcaktuara për përfundimin e mandateve sipas ligjit mbi bazën e të cilit janë fituar; (ii) përkundër reformave të vazhdueshme lidhur me Këshillin Prokurorial ndër vite, përfshirë ndryshimet në përbërjen e tij, me përjashtim të rastit të ndërprerjes së përfaqësimit sipas detyrës zyrtare të Ministrit të Drejtësisë në Këshill, që ishte propozuar nga vet Ministria përkatëse dhe nuk ishte kontestuar asnjëherë, mandatet e anëtarëve të Këshillit Prokurorial janë ruajtur vazhdimisht deri në skadimin e tyre të natyrshëm, përmes dispozitave tranzitore të të gjitha ligjeve përkatëse, përfshirë kur Këshilli Prokurorial ishte themeluar për herë të parë sipas nenit 110 të Kushtetutës pas shpalljes së pavarësisë së

Republikës së Kosovës, dhe kjo në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, është indikator i qartë i rëndësisë së sigurisë së mandateve të institucioneve të pavarura kushtetuese në rendin juridik të Republikës së Kosovës; dhe për më tepër, (iii) faktin që Gjykata ka konstatuar që një numër dispozitash esenciale të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me Kushtetutën, Aktgjykimi përfundimisht thekson që ndërprerja e mandateve të anëtarëve të Këshillit Prokurorial sipas Ligjit të kontestuar, nuk mund të shërbejë as si arsye bindëse për një “përmirësim të dukshëm të sistemit” e që mund t’i shërbente një qëllimi legjitim e proporcional, mbi bazën e të cilit do të mund të autorizohet përjashtimisht ndërprerja e mandateve të një institucioni të pavarur kushtetues, duke krijuar kështu një precedent me pasoja në sigurinë dhe pavarësinë e ushtrimit të funksionit të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe rrjedhimisht, edhe për rendin demokratik dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Në fund, Aktgjykimi sqaron që kërkesat e parashtruesve të kërkesës janë parashtruar në Gjykatë bazuar në paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe se kjo kategori e kërkesave ka karakter suspensiv, përkatësisht ligji i tillë mund t’i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje vetëm pas vendimmarrjes së Gjykatës dhe në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës për rastin e kontestuar. Në kontekst të praktikës së saj gjyqësore, siç është shtjelluar edhe në Aktgjykim, Gjykata vlerëson që marrë parasysh natyrën e dispozitave të Ligjit të kontestuar të shpallura në kundërshtim me Kushtetutën dhe faktin që pjesa tjetër e Ligjit të kontestuar do të ishte vështirë e zbatueshme pas shpalljes së dispozitave të lartcekura si të pavlefshme, Ligji i kontestuar, në shërbim të parimit të sigurisë juridike, duhet të shpallet i pavlefshëm në tërësinë e tij.



Aktgjykim

KI 69/21

Parashtrues

Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) dhe Partia Liberale Egjiptiane (PLE), të përfaqësuara nga Albert Kinolli dhe Veton Berisha, respektivisht

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [AA.nr.29/2021] të 12 marsit 2021

Rrethanat e rastit konkrete ndërlidhen me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 14 shkurt 2021. Dy kandidatët përfaqësues të subjekteve politike, PLE dhe PBREK, respektivisht dhe të cilët sipas rezultateve të certifikuara të zgjedhjeve parlamentare të lartcekura, nuk kishin arritur të fitojnë vende në Kuvend, pretendojnë që të drejtat e tyre zgjedhore janë cenuar si rezultat i vendimeve përkatëse të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) dhe Gjykatës Supreme, të cilat parashtruesit përkatës i kontestojnë para Gjykatës duke pretenduar shkelje të paragrafit 4 të nenit 58 [Përgjegjësitë e Shtetit], nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenit 64 [Struktura e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për sa i përket njërit nga kandidatët e lartcekur, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, PREBK, e të përfaqësuar para Gjykatës nga Albert Kinolli, Aktgjykimi sqaron që i njëjti nuk i ka shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj siç kërkohet përmes paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, sepse nuk i ka apeluar vendimet e PZAP-së të 7 dhe 10 marsit 2021, në Gjykatën Supreme. Ndërsa për sa i përket parashtruesit tjetër të kërkesës, përkatësisht PLE, e të përfaqësuar para Gjykatës nga Veton Berisha, Aktgjykimi sqaron që i njëjti konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme vetëm sa i përket refuzimit për anulimin/shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në

vendvotime të saktësuara në komunat e Kamenicës, Graçanicës dhe Mitrovicës së Veriut. Megjithatë, Vendimin plotësues të PZAP-së të 10 marsit 2021, që kishte vendosur përkitazi me Mitrovicën e Veriut, parashtruesi i kërkesës nuk e kishte apeluar në Gjykatën Supreme, duke dështuar për pasojë t'i shterojë mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Rrjedhimisht, sipas kërkesës së parashtruesit të kërkesës, vlerësimi meritor të Gjykatës i nënshtrohet Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme vetëm përkitazi me refuzimin e anulimit/shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotimet e saktësuara në komunat e Kamenicës dhe Graçanicës, respektivisht.

Në kontekstin e lartcekur, Aktgjykimi rikujton që si rezultat i dështimit të arritjes së votave të mjaftueshme për të fituar një vend në Kuvend, në zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit 2021, parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar ankesat/apelet përkatëse në PZAP dhe më pas në Gjykatë Supreme, duke pretenduar që votat e fituara nga Romani Iniciativa ishin “orkestruar dhe koordinuar” me “subjektin politik Lista Serbe” dhe se për pasojë, të gjitha votat që ky subjekt politik i ka fituar dhe që tejkalojnë numrin e votuesve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në vendvotimet përkatëse, duhet të shpallen të pavlefshme dhe të largohen nga rezultati zgjedhor.

PZAP dhe Gjykata Supreme kishin bazuar vendimmarrjen e tyre bazuar në këto pretendime dhe duke u referuar në paragrafin 4 të nenit 58 të Kushtetutës dhe paragrafin 2 të nenit 64 të Kushtetutës, por duke e anashkaluar nenin 45 të Kushtetutës, kishin anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotimet në vendvotime në komunat e Leposaviqit, Novobërdës, Ranillugut, Parteshit dhe Klllokotit, në esencë, duke përcaktuar standardin që të ushtruarit e të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në rendin juridik të Republikës së Kosovës, është e kushtëzuar me përkatësinë etnike të votuesit dhe të të votuarit. Më saktësisht, sipas PZAP-së dhe Gjykatës Supreme, (i) lidhur me njëzet (20) vendet e garantuara në Kuvend, në kontekst të të drejtave pasive zgjedhore, partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetet përkatëse që nuk janë shumicë, mund të votohen vetëm nga votuesit e të njëjtit komunitet; dhe për pasojë, në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore, votuesit mund të votojnë vetëm partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur që deklarohen se përfaqësojnë komunitetin e tyre; dhe (ii) votat e fituara për partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur, të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë një komunitet që nuk është

shumicë dhe që tejkalojnë numrin e votuesve që supozohet që i takojnë të njëjtit komunitet në një vendvotim të caktuar, shpallen të pavlefshme, sepse në të kundërtën “nuk ekziston lidhje objektive në mes të votuesve dhe subjektit të votuar”. PZAP dhe Gjykata Supreme, kalkulimin e proporcionit në mes të numrit të fletëvotimeve dhe votuesve që supozohet të përfaqësojnë një komunitet që nuk është shumicë, e kishin bazuar në të “dhëna të marra nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës të vitit 2011, por edhe raporteve kredibile të OSBE-së dhe Librat e Votuesve.”

Parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës, në esencë, pretendon që (i) fletëvotimet në vendvotimet përkatëse do të duhej të anulohen/shpallen të pavlefshme në proporcion me numrin e votuesve që përfaqësojnë komunitetin përkatës sepse në të kundërtën, përfaqësuesit të zgjedhur në Kuvend i “mungon lidhja objektive me komunitetin” që i njëjti deklaron që përfaqëson; dhe (ii) vendet e garantuara në Kuvend sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, mund të fitohen vetëm nëse votohen nga i njëjti komunitet të cilin partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur që garojnë për këto vende, deklarojnë që e përfaqësojnë. Thënë këtë, parashtruesi i kërkesës, vet thekson që në Republikën e Kosovës mungon baza “precize ligjore”, duke theksuar gjithashtu që “nuk ka praktika dhe norma precize ndërkombëtare” dhe të cilat në mënyrë shprehimore përcaktojnë që ulëset e garantuara për komunitetet që nuk janë shumicë mund të fitohen vetëm nëse votohen nga po i njëjti komunitet të cilin ata deklarojnë që e përfaqësojnë. Në mungesë të kësaj baze kushtetuese dhe ligjore, parashtruesi i kërkesës pretendon që bazuar në paragrafin 4 të nenit 58 të Kushtetutës, Gjykata duhet të detyrojë Kuvendin që të ndërmerr masa adekuate përmes nxjerrjes së ligjeve, përmes të cilave, do të sigurohej pjesëmarrja efektive e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, ashtu që dhe ndër tjerash, vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës do të fitoheshin vetëm nëse votohen nga anëtarët e të njëjtit komunitet të cilin ata deklarojnë që e përfaqësojnë dhe më saktësisht që, “komunitetet do të regjistroheshin në lista zgjedhore të veçanta ashtu që vetëm votuesit e komuniteteve që gjenden në ato lista të mund të votojnë për përfaqësuesit që janë deklaruar se do t'i përfaqësojnë ato komunitete në ulëse të garantuara”.

Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, Gjykata, për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, ka shtjelluar (i) parimet e përgjithshme për të drejtat zgjedhore sipas Kushtetutës; (ii) parimet e përgjithshme për përfaqësimin e komuniteteve që nuk

janë shumicë në Kosovë sipas Kushtetutës dhe Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; si dhe (iii) parimet e përgjithshme sipas Kodit të Praktikës së Mirë për Çështje Zgjedhore të Komisionit të Venecias dhe Rekomandimet e Lundit për Pjesëmarrjen Efektive të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike. Gjykata, gjithashtu, veçanërisht ka shtjelluar praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në interpretimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së në kontekst të (i) procedurave të nevojshme për anulimin e rezultateve zgjedhore, përfshirë shpalljen e pavlefshme të votave; dhe (ii) të drejtave zgjedhore dhe pakicave kombëtare. Në kontekst të kësaj të fundit, Aktgjykimi gjithashtu shtjellon opinionet dhe raportet e Këshillit të Evropës dhe Opinioneve të Komisionit të Venecias, përfshirë por duke mos u kufizuar në (i) raportin për Rregullat Zgjedhore dhe Veprimet Afirmative për Pjesëmarrjen e Pakicave Kombëtare në Procesin e Vendimmarrjes në Shtetet Evropiane; (ii) Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Zgjedhjet; dhe (iii) Përmbledhjen e Opinioneve dhe Raporteve lidhur me sistemet Zgjedhore dhe Pakicat Kombëtare.

Aktgjykimi sqaron që, çështja esenciale që ngërthen rastin konkret është nëse votat e qytetarëve të Republikës së Kosovës mund të anulohen/shpallen të pavlefshme bazuar në përkatësinë e tyre të supozuar etnike. Në këtë kontekst dhe bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Aktgjykimi thekson Gjykata është e detyruar që të drejtat dhe liritë themelore t'i interpretojë në harmoni me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe në kontekst të të drejtave zgjedhore, në harmoni me praktikën gjyqësore në interpretimin e nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Bazuar në këtë fundit, ndër tjerash dhe siç është shtjelluar në Aktgjykim, (i) nuk është roli i gjykatave të përcaktojnë vullnetin e votuesve; dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e votave duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore. Bazuar në këtë praktikë gjyqësore, Aktgjykimi më tej shtjellon nëse në Republikën e Kosovës fletëvotimet mund të shpallen të pavlefshme bazuar në përkatësinë e supozuar etnike të votuesve.

Fillimisht dhe në kontekst të vlefshmërisë dhe/ose pavlefshmërisë së fletëvotimeve, Aktgjykimi sqaron që (i) bazuar në paragrafin 1 të nenit 64 të Kushtetutës, vendet në Kuvend ndahen në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme të fituara prej subjekteve përkatëse politike; (ii) Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, përderisa nuk përcakton kriteret mbi bazën e të cilave mund të konstatohet pavlefshmëria e votave, përcakton PZAP-në si organ të pavarur e kompetent për të vendosur në lidhje me



ankesat/apellet e lejuara që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor; (iii) PZAP ka kompetencën për të anuluar/shpallur fletëvotime të pavlefshme në rrethana të jashtëzakonshme, por gjithnjë bazuar në rregullativën e aplikueshme, përkatësisht Kushtetutën, Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregulloret përkatëse të PZAP-së dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Në këtë kontekst, Aktgjykimi thekson që neni 45 i Kushtetutës është neni themelor që rregullon të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes. I njëjti përcakton që (i) çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor; (ii) vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë; dhe (iii) institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.

Aktgjykimi sqaron që bazuar në nenin 45 të Kushtetutës, aspekti aktiv i të drejtave zgjedhore, përkatësisht e drejta për të zgjedhur, i nënshtrohet vetëm dy kufizimeve kushtetuese, moshës dhe vendimit përkatës gjyqësor. Të njëjtat të drejta janë të garantuara edhe përmes Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ky i fundit, në Kreun II, përcakton të Drejtën për të Votuar, Listat e Votuesve dhe Periudhat e Kundërshtimit dhe Konfirmimit për Listën e Votuesve. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, në nenin 5 (E drejta për të Votuar) të tij, përcakton edhe disa kufizime që ndërlidhen me të drejtën për të votuar, ndërsa në nenin 7 (Lista e Votuesve) përcakton që qytetarët me të drejtë vote janë të regjistruar në Regjistrin Qendror Civil, duke saktësuar që informatat e nevojshme për Listën e Votuesve janë “emri, mbiemri, data e lindjes, adresa dhe Qendra e Votimit ku ai/ajo është caktuar për të votuar”, të dhëna këto që shënohen në gjuhët dhe alfabetet në të cilat shënimet origjinale mbahen në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë. Ligji dhe rregullativa e aplikueshme e KQZ-së, nuk përmban asnjë detyrim që votuesit të deklarojnë përkatësinë e tyre etnike për qëllime të Listës së Votuesve dhe ushtrimit të të drejtave aktive zgjedhore. Një qasje e tillë, në fakt, është në përputhje të plotë me instrumentet ndërkombëtare, duke përfshirë siç është sqaruar përmes Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore, dhe sipas të cilës, e ndër tjerash, as kandidatëve dhe as votuesve nuk duhet t’u kërkohej të tregojnë përkatësinë e tyre si pakicë kombëtare. Karakteristikat e votës që ndërlidhen me lirinë dhe fshehtësinë e saj janë të garantuara me të gjitha instrumentet ndërkombëtare,

siç sqarohet detajisht në Aktgjykim. Për më tepër, bazuar në rregullativën e aplikueshme të PZAP-së dhe KQZ-së, shpallja e pavlefshme e fletëvotimeve përfshinë vetëm rrethanat në të cilat (i) në fletëvotim është shënuar më shumë se një subjekt politik; (ii) mënyra se si është shënuar e bën qëllimin e votuesit të paqartë; (iii) fletëvotimet nuk janë vulosur me vulë zyrtare; dhe (iv) votuesi e shënon vetëm kandidatin dhe jo subjektin politik. Rregullativa e lartcekur nuk përcakton asnjë kriter mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet bazuar në përkatësinë etnike të votuesve.

Ndërsa, në kontekst të së drejtës për t’u zgjedhur, përkatësisht aspektit pasiv të të drejtave zgjedhore, neni 45 i Kushtetutës, me përjashtim të moshës dhe kufizimit përmes vendimit gjyqësor, nuk përcakton asnjë kufizim apo kushtëzim tjetër. Megjithatë, në kontekst të zgjedhjeve parlamentare, ky nen duhet të lexohet dhe interpretohet së bashku edhe me nenet 64 [Struktura e Kuvendit], 71 [Kualifikimet dhe Barazia Gjinore] dhe 73 [Pamundësia e Kandidimit] të Kushtetutës, respektivisht. I pari përcakton që, njëzet (20) vende në Kuvendin e Kosovës janë të garantuara për partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb ose komunitetet tjera, pa marrë parasysh numrin e vendeve të fituara, ndërsa i dyti dhe i treti, përcaktojnë kualifikimet e nevojshme për të kandiduar dhe rrethanat e pamundësisë së kandidimit për deputetë të Kuvendit. Për rrethanat e rastit konkret, relevante është ndërlidhshmëria e neneve 45 dhe 64 të Kushtetutës, respektivisht.

Më tej, Aktgjykimi sqaron që votën e fshehtë e përcakton edhe neni 64 i Kushtetutës, duke vënë theks gjithashtu në lista të hapura zgjedhore. Ky nen gjithashtu thekson që Kuvendi ka njëqind e njëzet (120) deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë, bazuar në listat e hapura, ku njëzet (20) vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë, në mënyrën e saktësuar në paragrafin 2 të nenit 64 të Kushtetutës. Këto garanci janë të saktësuar edhe në nenin 110 (Dispozitat e përgjithshme) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, sipas të cilit, ndër tjerash, Republika e Kosovës konsiderohet një zonë zgjedhore me shumë kandidatë. Procedurat përkitazi me regjistrimin e partive politike dhe subjekteve politike, saktësohen në Kreun III (Regjistrimi i partive politike dhe certifikimi i subjekteve politike) të këtij ligji. Asnjë nga këto procedura nuk përcakton përjashtime apo procedura të veçanta në kuptim të subjekteve politike që garojnë për vende të garantuara në Kuvend. Një kriter i tillë, duke u bazuar në paragrafin 2 të nenit 64 të Kushtetutës, në kontekst të regjistrimit të subjekteve

të lartcekura politike është i përcaktuar në rregullat e aplikueshme të KQZ-së, dhe të cilat në kuadër të dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin përkatës, gjithashtu parashohin “deklaratën e përkatësisë etnike të themeluesit të iniciativës politike”.

Thënë këtë, garantimi i vendeve të caktuara në Kuvend për komunitetet që nuk janë shumicë, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore siç janë sqaruar më lart, jodetyrimisht ngërthen edhe detyrimin që këto vende të mund të fitohen vetëm nëse janë votuar nga po i njëjti komunitet që nuk është shumicë, duke kushtëzuar për pasojë edhe të drejtat aktive zgjedhore në përkatësi etnike. Raportet dhe opinionet e Komisionit të Venecias, përfshirë raportet shpjeguese të instrumenteve ndërkombëtare siç janë sqaruar në Aktgjykim, sqarojnë sistemet zgjedhore në të gjitha shtetet evropiane dhe më gjerë në kontekst të akomodimit të pakicave kombëtare dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, ndër tjerash, theksojnë që (i) ka sisteme zgjedhore të cilat në kontekst të të drejtave pasive zgjedhore përcaktojnë garanci dhe/ose lehtësi shtesë lidhur me pakicat kombëtare, përfshirë vende të garantuara në kuvendet përkatëse, ndërsa në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore vënë theksin në lirinë dhe fshehtësinë e votës; dhe (ii) përjashtimisht dhe në raste të veçanta, në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore, mundësojnë votën e dyfishtë ose lista të veçanta zgjedhore për pakicat kombëtare, mekanizma këto të përcaktuara saktësisht në Kushtetutat dhe/ose ligjet e aplikueshme. Në Republikën e Kosovës, një sistem i tillë, i cili përcakton sistem të veçantë zgjedhor për komunitetet që nuk janë shumicë në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore, nuk është i përcaktuar me Kushtetutë dhe as në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Sipas Kushtetutës, vota është personale, e lirë, e barabartë dhe e fshehtë, ndërsa dhe ndër tjerash, sipas Kodit të Praktikave të Mira për Çështje Zgjedhore, as kandidatët dhe as votuesit nuk janë të detyruar të zbulojnë përkatësinë e tyre si pakicë kombëtare.

Për më tepër, Aktgjykimi i referohet edhe rastit të fundit të GJEDNJ-së, përkatësisht Bakirdzi dhe E.C kundër Hungarisë, i cili ka marrë formë të prerë më 3 prill 2023. Ky rast është tejet relevant për rrethanat e rastit konkret, sepse ndër të tjera, ka të bëjë me (i) shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve; (ii) mangësitë e sistemit të votimit të pakicave kombëtare që ndikojnë në fshehtësinë e votimit; (iii) sistemet që kërkojnë që një kandidat i pakicës kombëtare të zgjedhet vetëm nga votuesit e të njëjtës pakicë; dhe (iv) sistemet që lejojnë votuesit e pakicave kombëtare të votojnë vetëm për listat e tyre përkatëse të pakicave

kombëtare dhe jo për listat e përgjithshme të partive politike. Në këtë rast, dhe përkundër faktit që vet ligji hungarez përcakton ndërlidhjen në mes të të drejtave aktive dhe pasive zgjedhore me përkatësinë etnike përkatëse lidhur me vende të caktuara në kuvend, GJEDNJ, në kontekst të rrethanave të rastit përkatës, konstatoi që të drejtat zgjedhore të votuesve të pakicave kombëtare ishin cenuar në kundërshtim me garancitë e përcaktuara përmes nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke theksuar, ndër tjerash, që (i) ka dyshime se një sistem në të cilin vota mund të hidhet vetëm për një listë specifike të mbyllur të kandidatëve dhe që kërkon nga votuesit të braktisin përkatësitë e tyre partiake në mënyrë që të kenë përfaqësim si anëtar të një pakice kombëtare, siguron “shprehje të lirë të mendimit të popullit në zgjedhjen e legjislativit”; dhe (ii) e drejta për fshehtësi të plotë të votës në rrethana të tilla, nuk është në dispozicion të votuesve të pakicës kombëtare.

Bazuar në sqarimet e lartcekura, Aktgjykimi thekson që (i) sipas paragrafit 2 të nenit 45 të Kushtetutës, vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë; (ii) sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, pa marrë parasysh numrin e vendeve të fituara, njëzet (20) vende në Kuvendin e Republikës së Kosovës i takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në mënyrën e saktësuar në këtë nen; (iii) Kushtetuta, instrumentet ndërkombëtare të saktësuar në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të saj, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore, nuk përfshijnë detyrimin që votuesit të zgjedhin vetëm partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur që deklarohen që përfaqësojnë komunitetin që ata i përkasin dhe në kontekst të të drejtave pasive zgjedhore, as vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës për partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët të pavarur, nuk janë të kushtëzuara vetëm në votën e qytetarëve që u përkasin komuniteteve që ata deklarojnë që i përfaqësojnë; (iv) nëse shteti përcaktohet për një sistem të tillë, i njëjti duhet të jetë i përcaktuar përmes ligjeve të miratuara nga Kuvendi dhe në përputhje me përcaktimet dhe vlerat kushtetuese; dhe (v) sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është roli i gjykatave të përcaktojnë vullnetin e votuesve dhe çdo shpallje e pavlefshme e votave duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore dhe në procedurë të saktë të ndjekur, siç është përcaktuar në ligjet dhe rregullativën e aplikueshme. Në kontekst të këtyre të fundit, Aktgjykimi sqaron që në kuadër të sistemit zgjedhor në Republikën e Kosovës, nuk ka asnjë bazë ligjore mbi të cilën do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet në

të lartcekura politike është i përcaktuar në rregullat e aplikueshme të KQZ-së, dhe të cilat në kuadër të dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin përkatës, gjithashtu parashohin “deklaratën e përkatësisë etnike të themeluesit të iniciativës politike”.

Thënë këtë, garantimi i vendeve të caktuara në Kuvend për komunitetet që nuk janë shumicë, bazuar në dispozitat kushtetuese dhe ligjore siç janë sqaruar më lart, jodetyrimisht ngërthen edhe detyrimin që këto vende të mund të fitohen vetëm nëse janë votuar nga po i njëjti komunitet që nuk është shumicë, duke kushtëzuar për pasojë edhe të drejtat aktive zgjedhore në përkatësi etnike. Raportet dhe opinionet e Komisionit të Venecias, përfshirë raportet shpjeguese të instrumenteve ndërkombëtare siç janë sqaruar në Aktgjykim, sqarojnë sistemet zgjedhore në të gjitha shtetet evropiane dhe më gjerë në kontekst të akomodimit të pakicave kombëtare dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, ndër tjerash, theksojnë që (i) ka sisteme zgjedhore të cilat në kontekst të të drejtave pasive zgjedhore përcaktojnë garanci dhe/ose lehtësi shtesë lidhur me pakicat kombëtare, përfshirë vende të garantuara në kuvendet përkatëse, ndërsa në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore vënë theksin në lirinë dhe fshehtësinë e votës; dhe (ii) përjashtimisht dhe në raste të veçanta, në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore, mundësojnë votën e dyfishtë ose lista të veçanta zgjedhore për pakicat kombëtare, mekanizma këto të përcaktuara saktësisht në Kushtetutat dhe/ose ligjet e aplikueshme. Në Republikën e Kosovës, një sistem i tillë, i cili përcakton sistem të veçantë zgjedhor për komunitetet që nuk janë shumicë në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore, nuk është i përcaktuar me Kushtetutë dhe as në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Sipas Kushtetutës, vota është personale, e lirë, e barabartë dhe e fshehtë, ndërsa dhe ndër tjerash, sipas Kodit të Praktikave të Mira për Çështje Zgjedhore, as kandidatët dhe as votuesit nuk janë të detyruar të zbulojnë përkatësinë e tyre si pakicë kombëtare.

Për më tepër, Aktgjykimi i referohet edhe rastit të fundit të GJEDNJ-së, përkatësisht Bakirdzi dhe E.C kundër Hungarisë, i cili ka marrë formë të prerë më 3 prill 2023. Ky rast është tejet relevant për rrethanat e rastit konkret, sepse ndër të tjera, ka të bëjë me (i) shprehjen e lirë të vullnetit të votuesve; (ii) mangësitë e sistemit të votimit të pakicave kombëtare që ndikojnë në fshehtësinë e votimit; (iii) sistemet që kërkojnë që një kandidat i pakicës kombëtare të zgjedhet vetëm nga votuesit e të njëjtës pakicë; dhe (iv) sistemet që lejojnë votuesit e pakicave kombëtare të votojnë vetëm për listat e tyre përkatëse të pakicave

kombëtare dhe jo për listat e përgjithshme të partive politike. Në këtë rast, dhe përkundër faktit që vet ligji hungarez përcakton ndërlidhjen në mes të të drejtave aktive dhe pasive zgjedhore me përkatësinë etnike përkatëse lidhur me vende të caktuara në kuvend, GJEDNJ, në kontekst të rrethanave të rastit përkatës, konstatoi që të drejtat zgjedhore të votuesve të pakicave kombëtare ishin cenuar në kundërshtim me garancitë e përcaktuara përmes nenit 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke theksuar, ndër tjerash, që (i) ka dyshime se një sistem në të cilin vota mund të hidhet vetëm për një listë specifike të mbyllur të kandidatëve dhe që kërkon nga votuesit të braktisin përkatësitë e tyre partiake në mënyrë që të kenë përfaqësim si anëtar të një pakice kombëtare, siguron “shprehje të lirë të mendimit të popullit në zgjedhjen e legjislativit”; dhe (ii) e drejta për fshehtësi të plotë të votës në rrethana të tilla, nuk është në dispozicion të votuesve të pakicës kombëtare.

Bazuar në sqarimet e lartcekura, Aktgjykimi thekson që (i) sipas paragrafit 2 të nenit 45 të Kushtetutës, vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë; (ii) sipas paragrafit 2 të nenit 64 të Kushtetutës, pa marrë parasysh numrin e vendeve të fituara, njëzet (20) vende në Kuvendin e Republikës së Kosovës i takojnë komuniteteve që nuk janë shumicë në mënyrën e saktësuar në këtë nen; (iii) Kushtetuta, instrumentet ndërkombëtare të saktësuar në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të saj, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, në kontekst të të drejtave aktive zgjedhore, nuk përfshijnë detyrimin që votuesit të zgjedhin vetëm partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët e pavarur që deklarohen që përfaqësojnë komunitetin që ata i përkasin dhe në kontekst të të drejtave pasive zgjedhore, as vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës për partitë, koalicionet, nismat qytetare dhe kandidatët të pavarur, nuk janë të kushtëzuara vetëm në votën e qytetarëve që u përkasin komuniteteve që ata deklarojnë që i përfaqësojnë; (iv) nëse shteti përcaktohet për një sistem të tillë, i njëjti duhet të jetë i përcaktuar përmes ligjeve të miratuara nga Kuvendi dhe në përputhje me përcaktimet dhe vlerat kushtetuese; dhe (v) sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk është roli i gjykatave të përcaktojnë vullnetin e votuesve dhe çdo shpallje e pavlefshme e votave duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore dhe në procedurë të saktë të ndjekur, siç është përcaktuar në ligjet dhe rregullativën e aplikueshme. Në kontekst të këtyre të fundit, Aktgjykimi sqaron që në kuadër të sistemit zgjedhor në Republikën e Kosovës, nuk ka asnjë bazë ligjore mbi të cilën do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet në

vendvotime të caktuara, duke u bazuar mbi supozimet për përkatësinë etnike të votuesve, përfshirë proporcionin në mes të numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet që nuk është shumicë dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara.

Rrjedhimisht, dhe në mungesë të një baze kushtetuese dhe/ose ligjore për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotime të caktuara në komunat e Kamenicës dhe Graçanicës, respektivisht, Gjykata konstaton që refuzimi i anulimit/shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve në komunat e lartcekura përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, nuk ka rezultuar në cenimin e të drejtave të parashtruesit të kërkesës për t'u zgjedhur në Kuvendin e Kosovës sipas paragrafit 1 të nenit 45 të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Në fakt, parashtruesi i kërkesës edhe vet vë theksin në faktin që nuk ka bazë kushtetuese dhe/ose ligjore në Republikën e Kosovës për të shpallur të pavlefshme fletëvotimet bazuar në përkatësinë etnike të votuesve. Për pasojë, kërkon nga Gjykata që e njëjta të detyrojë Kuvendin e Republikës së Kosovës që të ndërmerr masa adekuate, përmes nxjerrjes së ligjeve që mund të përcaktojnë lista të veçanta për komunitetet që nuk janë shumicë, përmes të cilave, do të sigurohej pjesëmarrja efektive e komuniteteve, ashtu që dhe ndër tjerash, vendet e garantuara në Kuvendin e Kosovës do të mund të fitoheshin vetëm nëse votohen nga anëtarët e të njëjtit komunitet të cilin ata deklarohen që e përfaqësojnë.

Thënë këtë, ndër tjerash, Aktgjykimi sqaron që në kontekst të kërkesave të parashtruara bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, siç janë rrethanat e rastit konkret, individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale. Ndërsa, bazuar në nenin 63 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, institucion ligjvënës i Republikës së Kosovës është Kuvendi. Ky i fundit ka kompetencën e plotë që të përcaktojë modelin dhe specifikat e sistemit zgjedhor përmes ligjeve të miratuara. Bazuar në parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ligjet e miratuara nga Kuvendi mund t'i nënshtrohen vlerësimit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese, nëse kontestohen para saj bazuar në dispozitat e nenit 113 të Kushtetutës.

Në fund, Aktgjykimi sqaron edhe në tri çështje tjera dhe të cilat ndërlidhen me rrethanat e rastit konkret, si në vijim (i) një Aktgjykim tjetër të Gjykatës Supreme dhe i cili ka vendosur ngjashëm si në rrethanat e parashtruesit të kërkesës; (ii) detyrimin e ndjekjes së

procedurave të nevojshme për shpalljen e pavlefshme të votave, duke përfshirë edhe trajtimin e pretendimeve për shkelje, përkatësisht vepra të mundshme penale, lidhur me zbatimin e rregullave dhe procedurave zgjedhore, siç janë të përcaktuara në ligjet e aplikueshme; dhe (iii) efektet e këtij Aktgjykimi.

Lidhur me çështjen e parë, Aktgjykimi sqaron që parashtruesi i kërkesës në parashtrësën e tij i është referuar edhe një Aktgjykim të Gjykatës Supreme, përkatësisht [AA.nr.30/2021], që është nxjerrë pas apeleve të subjekteve politike që përfaqësojnë komunitetin boshnjak Nasha Iniciativa; Lista Boshnjake Unioni Social Demokrat dhe Nova Demokratska Stranka, dhe i cili, sipas parashtruesit të kërkesës, bazuar në të njëjtin interpretim të paragrafit 4 të nenit 58 të Kushtetutës, ka anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotimet në të gjitha vendvotimet të cilat ishin kontestuar nga subjektet politike ankuese. Gjykata sqaron që, ky Aktgjykim asnjëherë nuk është kontestuar para Gjykatës dhe për pasojë nuk i është nënshtruar vlerësimit të kushtetutshmërisë së tij.

Lidhur me çështjen e dytë, Aktgjykimi sqaron që paragrafi 1 i nenit 64 të Kushtetutës i referohet specifikisht "numrit të votave të vlefshme" në përcaktimin e vendeve të fituara në Kuvendin e Republikës, ndërsa bazat përkatëse ligjore dhe mënyra e shpalljes së votave të pavlefshme është e përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativën tjetër të aplikueshme zgjedhore. Aktgjykimi vë theks në faktin që, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, shpallja e pavlefshme e votave, duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore. Për më tepër, Gjykata thekson që veprat penale kundër të drejtave të votimit janë të përcaktuara në Kapitullin XVIII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Pretendimet për shkelje përgjatë procesit zgjedhor, duke përfshirë keqpërdorimin e të drejtës së votimit dhe procedurat si të njëjtat adresohen, janë të saktësuara në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, por edhe në Kodin e Penal dhe atë të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Në fund, dhe lidhur me çështjen e tretë, përkatësisht efektet e këtij Aktgjykimi, ky i fundit sqaron që, ashtu siç Gjykata ka saktësuar në Aktgjykime paraprake që ndërlidhen me të drejta individuale në konteste paszgjedhore që ndërlidhen me zgjedhje parlamentare, përkatësisht në (i) Aktgjykimin KI207/19, me parashtrues NISMA Socialdemokrate, Aleanca Kosova e Re dhe Partia e Drejtësisë, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimeve [A.A.U.ZH.nr.20/2019] të 30 tetorit 2019 dhe [A.A.U.ZH.nr.21/2019] të 5 nëntorit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës; dhe



(ii) Aktgjykimin në rastet KI45/20 dhe KI46/20, me parashtruese Tinka Kurti dhe Drita Millaku, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimeve [AA.nr. 4/2020] të 19 shkurtit 2020 dhe [AA.nr.3/2020] të 19 shkurtit 2020 të Gjykatës Supreme, bazuar në parimin e sigurisë juridike, ky Aktgjykim nuk mund të prodhojë efekt juridik prapaveprues në rezultatin e shpallur zgjedhor përkitazi me zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit 2021.

Gjykata, njëzëri, ka vendosur që (i) kërkesën e parashtruar nga PREBK, të deklarojë të papranueshme, si rezultat i mosshterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj; dhe (ii) kërkesën e parashtruar nga PLE, të deklarojë të pranueshme për shqyrtim në merita; ndërsa, me shumicë, ka vendosur që (iii) të konstatojë që Aktgjykimi [AA.nr.29/2021] i 12 marsit 2021 i Gjykatës Supreme nuk ka cenuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht PLE-së, për t'u zgjedhur në Kuvend pas zgjedhjeve parlamentare të 14 shkurtit 2021, sipas paragrafit 1 të nenit 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] të Kushtetutës në lidhje me nenin 3 (E drejta për zgjedhje të lira) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; dhe (iv) të konstatojë që ky Aktgjykim nuk ka efekt prapaveprues dhe që në bazë të parimit të sigurisë juridike, nuk afekton të drejtat e palëve të treta.



GJEDNJ – Vendime të rëndësishme (1 janar – 30 qershor 2023)

* Etiketimi i një libri me përralla për fëmijë si i dëmshëm vetëm për shkak të përmbajtjes LGBTI ka shkelur Konventën (23/01/2023)

Rasti i **Macate kundër Lituanisë** (kërkesa nr. 61435/19) kishte të bënte me një libër për fëmijë me përralla që përmbante tregime për martesën e personave të së njëjtës gjini. Shpërndarja e librit ishte pezulluar menjëherë pas botimit të tij në vitin 2013. Ai kishte rifilluar një vit më vonë pasi libri ishte etiketuar si i dëmshëm për fëmijët nën moshën 14 vjeçare. Ky ishte rasti i parë në të cilin Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut kishte vlerësuar kufizimet në literaturë për marrëdhëniet e së njëjtës gjini të shkruar veçanërisht për fëmijët. Në aktgjykimin e Dhomës së Madhe rreth rastit, Gjykata Evropiane vendosi njëzëri se kishte pasur **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata konstatoi se masat kundër librit të parashtruesit kishin për qëllim të kufizonin qasjen e fëmijëve në informacion që paraqiste marrëdhëniet e së njëjtës gjini si thelbësisht të barabarta me marrëdhëniet e gjinive të ndryshme. Në veçanti, nuk mund të shihte se si, sipas gjykatave kombëtare dhe qeverisë, disa pjesë të caktuara - princesha dhe vajza e këpucarit duke fjetur në krahët e njëra-tjetres pas dasmës së tyre – ishin eksplicite në aspektin seksual. Ajo madje as nuk u bind nga argumenti i qeverisë se libri kishte promovuar familjet e të njëjtës gjini në raport me të tjerat. Përkundrazi, përrallat kishin mbrojtur respektin dhe pranimin e të gjithë anëtarëve të shoqërisë në një aspekt themelor të jetës së tyre, pra një marrëdhënie të përkushtuar. Si rezultat, ajo arriti në përfundim se kufizimi i qasjes së fëmijëve në informacion të tillë nuk kishte ndjekur asnjë qëllim që ajo mund t'a pranonte si legjitim.

* Refuzimi i autoriteteve për të zëvendësuar termin “mashkull” me termin “neutral” ose “interseksual” në certifikatën e lindjes së parashtruesit nuk ka shkelur nenin 8 të Konventës (31/01/2023)

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin e **Y kundër Francës** (kërkesa nr. 76888/17), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi me gjashtë vota për dhe një kundër se **nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Parashtruesi, i cili është një person biologjikisht interseksual, ankohet për refuzimin e gjykatave vendore për të pranuar kërkesën e tij për të futur fjalën “neutral” ose “interseksual” në certifikatën e tij të lindjes në vend të fjalës “mashkull”.

Në shqyrtimin e çështjes në kuptim të detyrimit pozitiv të shtetit të paditur për t'i siguruar parashtruesit respekt efektiv për jetën e tij private, Gjykata vlerësoi nëse interesi i përgjithshëm ishte

peshuar siç duhet kundrejt interesave të parashtruesit. Gjykata vuri në dukje, së pari, se aspekti thelbësor i identitetit intim individual ishte kryesore në çështjen në fjalë, në atë se identiteti gjinor ishte në diskutim, dhe pranoi se mospërputhja ndërmjet identitetit biologjik të parashtruesit dhe identitetit ligjor të tij mund të shkaktojë vuajtje dhe ankth për të. Gjykata pastaj pranoi se argumentet paraqitura nga autoritetet kombëtare në refuzimin e kërkesës së parashtruesit, bazuar në respektimin e parimit të patjetërsueshmërisë së gjendjes civile dhe nevojën për të ruajtur konsistencën dhe besueshmërinë e të dhënave të gjendjes civile dhe të aranzhimeve sociale dhe ligjore në dispozicion në Francë, ishin të relevante. Ajo gjithashtu mori në konsideratë argumentimin e Gjykatës së Kasacionit sipas të cilit njohja gjyqësore e një gjinie si “neutrale” do të kishte pasoja të mëdha për rregullat e ligjit francez, të ndërtuara mbi bazën e dy gjinive, dhe do të nënkuptonte ndryshime të shumta koordinuese legjislative. Pasi vuri në dukje se Gjykata e Apelit në Orléans kishte vendosur se pranimi i kërkesës së parashtruesit do të përbënte njohjen e ekzistencës së një kategorie tjetër gjinore dhe për rrjedhojë ushtrimin e një funksioni normativ, i cili në parim ishte çështje e ligjvënësve dhe jo e gjyqësorit, Gjykata vuri në dukje se respektimi i parimit të ndarjes së pushteteve, pa të cilin nuk do të kishte demokraci, ishte në qendër të vëmendjes në konsideratat e gjykatave vendore. Duke njohur faktin se, megjithëse parashtruesi deklaroi se nuk po kërkonte përcaktimin e një të drejte të përgjithshme për njohjen e një gjinie të tretë, por vetëm për korrigjimin e gjendjes së tij civile, Gjykata vuri në dukje se nëse do të pranonte pretendimin e parashtruesit, kjo do të nënkuptonte domosdoshmërisht se shtetit të paditur do t'i kërkohej, me qëllim që të përmbushë detyrimet e tij sipas nenit 46 të Konventës, të ndryshojë ligjin e tij kombëtar për këtë qëllim; për rrjedhojë, Gjykata vlerësoi se ajo gjithashtu ishte e detyruar të përmbahej. Në çështjet e politikës së përgjithshme mbi të cilat opinionet brenda një shoqërie demokratike mund të ndryshojnë në mënyrë të arsyeshme gjerësisht, një peshë e veçantë duhej t'i jepej rolit të politikëbërësit vendor. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë kur, si në rastin konkret, çështja ishte ajo në të cilën shoqëria do të duhej të bënte një zgjedhje. Në mungesë të një konsensusi evropian në këtë fushë, ishte e përshtatshme që t'i lihej shtetit përgjegjës të vendoste se me çfarë shpejtësie dhe në çfarë mase mund të plotësonte kërkesat e personave interseksual, si parashtruesi, në lidhje me gjendjen civil, duke marrë parasysh situatën e vështirë në të cilën ata gjendeshin sa i përket të drejtës për respektim të jetës private, veçanërisht ndryshimit ndërmjet pozicionit ligjor dhe realitetit biologjik të tyre. Gjykata arriti në përfundimin se, duke pasur parasysh diskrecionin (“kufirin e vlerësimit”) që gëzonte shteti i paditur, Franca nuk kishte dështuar në detyrimin e saj pozitiv për të siguruar respekt efektiv për jetën private të parashtruesit; si rrjedhojë nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.



*** Ankesat për uljen e pensioneve të pleqërisë në Serbi mes masave shtrënguese, të papranueshme (09/02/2023)**

Rasti i **Žegarac dhe të tjerët kundër Serbisë** (kërkesa nr. 54805/15 dhe 10 kërkesa tjera) kishte të bënte kryesisht me ankesat e 11 parashtruesve se pagesa e pensioneve të tyre të pleqërisë ishte ulur nga nëntori 2014 deri në shtator 2018. Ulja pasoi ndryshimet legislative të paraqitura nga qeveria si pjesë e një grupi më të gjerë masash shtrënguese. Legjislacioni ishte shfuqizuar pasi që ishte konsideruar se borxhi publik ishte ulur mjaftueshëm. Në aktgjykimin e saj, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, njëzëri vendosi të deklarojë tetë prej kërkesave të papranueshme. Ajo vendosi në veçanti se ulja e pagesave të pensioneve ishte kufizuar për përfituesit e pensioneve më të larta, kishte qenë e përkohshme – që zgjati pak më pak se katër vite – dhe kishte qenë pjesë e përpjekjes për të balancuar buxhetin shtetëror. Prandaj, autoritetet kishin vendosur një ekuilibër të drejtë ndërmjet sigurimit të stabilitetit financiar të sistemit të pensioneve – që ishte në interesin e përgjithshëm të publikut – dhe mbrojtjes së të drejtave pronësore të parashtruesve, për të parandaluar që ata të mbajnë një barrë individuale dhe tejet të madhe. Ajo gjithashtu vendosi, njëzëri, të heqë tri kërkesat tjera nga lista e rasteve. Në njërin prej këtyre rasteve, Gjykata nuk kishte marrë përgjigje në korrespondencën e saj, ndërsa parashtruesit në dy rastet e tjera kishin vdekur pa pasur trashëgimtarë që të paraqisnin kërkesë për të vazhduar procedurat para saj.

*** Shkelja e lirisë së shprehjes së një sinjalizuesi si rezultat i dënimit të tij penal (14/02/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës së Madhe në rastin e **Halet kundër Luksemburgut** (kërkesa nr. 21884/18), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi me shumicë votash (dymbëdhjetë vota për dhe pesë kundër), se kishte pasur **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me zbulimin nga ana e z. Halet, ndërsa kishte qenë i punësuar në një kompani private, të dokumenteve konfidenciale të mbrojtura nga sekreti profesional, duke përfshirë 14 deklarata tatimore të kompanive multinationale dhe dy letra shoqëruese, të marra nga vendi i tij i punës. Pas ankesës nga punëdhënësi i tij dhe në mbyllje të procedurës penale kundër tij, z. Halet u urdhërua nga Gjykata e Apelit në apel të paguante një gjobë penale prej 1,000 euro dhe të paguante një shumë simbolike prej 1 euro si kompensim për dëmin jopasuror që i kishte shkaktuar punëdhënësit të tij. Duke pasur parasysh gjetjet e saj për rëndësinë, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë evropian, të debatit publik mbi praktikën tatimore të kompanive multinationale, për të cilat informacioni i zbuluar nga parashtruesi kishte dhënë kontribut thelbësor, Gjykata vlerësoi se interesi publik në zbulimin e atij informacioni

tejkallonte të gjitha efektet e dëmshme që lindnin prej tij. Kështu që, pas peshimit e të gjitha interesave të përfshira dhe duke marrë parasysh natyrën, rëndësinë dhe ndikimin e qetësues të dënimit penal të parashtruesit, Gjykata arriti në përfundimin se ndërhyrja në të drejtën e tij për liri të shprehjes, veçanërisht lirinë e tij për të dhënë informacion, nuk ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

*** Vendimi për kthimin e një fëmije të rrëmbyer te babai i tij në SHBA nuk binte ndesh me të drejtat e nënës sipas Konventës Evropiane (21/02/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin e **GK kundër Qipros** (kërkesa nr. 16205/21), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi njëzëri se **nuk kishte shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me procedurën dhe urdhrin pasues nga gjykatat qipriote për kthimin e djalit të parashtrueses në Shtetet e Bashkuara të Amerikës sipas Konventës së Hagës të 25 tetorit 1980 mbi Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijëve. Gjykata gjeti, në veçanti, se gjykatat vendore nuk kishin urdhëruar automatikisht kthimin e fëmijës. Ato kishin marrë parasysh të gjitha argumentet e palëve dhe kishin marrë vendime të hollësishme, të cilat, sipas tyre, mbronin interesin më të mirë të fëmijës dhe përjashtonin çdo rrezik serioz për të. Në tërësi, procesi i vendimmarrjes nuk ishte në kundërshtim me kërkesat procedurale sipas nenit 8 të Konventës dhe parashtruesja nuk kishte pësuar ndërhyrje joproporcionale në të drejtën e saj për respektimin e jetës së saj familjare. Gjykata nënvizoi se qëllimi i Konventës së Hagës ishte të parandalonte që prindi rrëmbyes të mos lejohej të përfitonte nga keqbërjet e tij/saj.

*** Rusia përgjegjëse për arrestimet, keqtrajtimet dhe ndalimin e paligjshëm të dy burrave në rrezik nga autoritetet de facto abkaze (07/03/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin e **Mamasakhlisi dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë dhe Rosisë** (kërkesa nr. 29999/04 dhe 41424/04), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi njëzëri se kishte pasur, në lidhje me parashtruesin e parë dhe të tretë:

- shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues),
- shkelje të nenit 5 § 1(a)(c) (e drejta për liri dhe siguri), dhe
- shkelje e nenit 6 §§ 1 dhe 3(c) (e drejta për një proces të rregullt)

të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nga Federata Ruse dhe asnjë shkelje nga Gjeorgjia. Rasti kishte të bënte me ngjarjet para konfliktit të armatosur në vitin 2008 ndërmjet Gjeorgjisë dhe Rosisë dhe, veçanërisht, arrestimet e z. Mamasakhlisi në vitin



2001 dhe z. Nanava në vitin 2003, dhe pretendimet e tyre për keqtrajtim, dënim dhe burgosje të vazhdueshme nga autoritetet de facto abkaze. Gjykata konstatoi se, ndërsa Gjeorgjia nuk kishte ushtruar kontroll mbi territorin abkaz në atë kohë, ajo kishte juridiksion për shkak të ngjarjeve që kishin ndodhur në territorin e saj të njohur nga e drejta ndërkombëtare publike. Sa i përket Rusesë, Gjykata arriti në përfundimin se, për shkak të mbështetjes së saj të qëndrueshme dhe thelbësore politike dhe ekonomike për Abkhazinë dhe përfshirjes së madhe ushtarake, Rusia kishte ushtruar kontroll efektiv dhe ndikim vendimtar mbi këtë zonë dhe kështu kishte juridiksion në lidhje me çështjet për të cilat është bërë ankesë. Gjykata gjeti se arrestimet dhe ndalimi i z. Mamasakhlisi dhe z. Nanava kishin qenë të paligjshme. Z. Mamasakhlisi ishte keqtrajtuar dhe ndaluar në kushte çnjerëzore dhe degraduese. Asnjëri prej parashtruesve nuk kishte marrë kujdesin e duhur mjekësor ose nuk kishte përfituar nga një seancë e drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj. Ata nuk kishin mundur të organizonin mbrojtjen e tyre dhe të përfitonin në mënyrë efektive nga ndihma e një avokati. Sa i përket ndarjes së përgjegjësisë për shkeljet e Konventës, Gjykata gjeti Rusinë përgjegjëse për shkeljet dhe nuk gjeti asnjë shkelje nga Gjeorgjia. Gjykata vlerësoi në veçanti se qeveria gjeorgjiane kishte bërë gjithçka që ishte brenda mundësive të saj për të siguruar të drejtat e z. Mamasakhlisi dhe të z. Nanava sipas Konventës, por kishte hasur në refuzime të vazhdueshme të autoriteteve de facto abkaze për të bashkëpunuar dhe në mosveprimin e autoriteteve ruse për të marrë masat e nevojshme për të adresuar ankesat pasi ato i ishin njoftuar për to. Si rezultat i mbështetjes së vazhdueshme për Abkhazinë gjatë periudhës përkatëse, Rusia ishte përgjegjëse për shkeljet e të drejtave të parashtruesve.

*** Publikimi sistematik i të dhënave personale të borxhlinjve tatimor në Hungari ka shkelur Konventën (09/03/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës së Madhe në rastin e **LB kundër Hungarisë** (kërkesa nr. 36345/16), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi me 15 vota për dhe 2 kundër se kishte pasur shkelje **të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare dhe të shtëpisë)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me politikën ligjore hungareze të publikimit të të dhënave personale të tatimpaguesve të cilët ishin në borxh. Parashtruesi u ankues në veçanti se emri dhe adresa e tij e shtëpisë ishin publikuar në një listë të “borxhlinjve tatimore të mëdhenj” në faqen e autoriteteve tatimore sipas ndryshimit të vitit 2006 në legjislacionin përkatës tatimor. Gjykata konstatoi se skema e ndryshuar e publikimit kishte qenë sistematike, pa peshuar interesin publik në sigurimin e disiplinës tatimore ndaj të drejtave të privatësisë së individit. Në veçanti, Parlamenti nuk kishte vlerësuar skemat e mëparshme të publikimit dhe ndikimin e tyre

tek tatimpaguesit apo reflektuar se cila do të ishte vlera shtesë e skemës së ndryshuar të vitit 2006. Përveç kësaj, pak ose aspak nuk i ishte kushtuar vëmendje mbrojtjes së të dhënave, rrezikut të keqpërdorimit nga publiku i gjerë i adresës së shtëpisë së një borxhliu tatimor ose shtrirjes së internetit në mbarë botën. Prandaj, Gjykata nuk ishte e bindur, pavarësisht nga diskrecioni i gjerë i shtetit të paditur për të vendosur për çështje të tilla, se arsyet e ligjvënësit hungarez për miratimin e skemës së ndryshuar të publikimit, megjithëse të rëndësishme, kishin qenë të mjaftueshme për të treguar se ndërhyrja në të drejtat e parashtruesit kishte qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike”.

*** Hungaria duhet të zhvillojë një politikë për t'i dhënë fund ndarjes në arsim (30/03/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin e **Szolcsán kundër Hungarisë** (kërkesa nr. 24408/16), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se kishte pasur **shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në ndërlidhje me nenin 2 të Protokollit nr. 1 (e drejta për arsim). Rasti kishte të bënte me shkollimin e parashtruesit në një shkollë fillore që frekuentohej pothuajse ekskluzivisht nga fëmijët romë. Kërkesa e tij për t'u transferuar në një shkollë tjetër në një qytet fqinj u refuzua sepse ai nuk jetonte në zonën që mbulohej nga shkolla. Megjithatë, ai pretendon se rreth një e katërta e nxënësve të asaj shkolle jetonin në të njëjtin qytet me të, i cili ishte në distancë të lehtë pasi ishte pesë minuta larg me transportin publik. Ai pretendon se programi mësimor që mësohej në shkollën që ai gravitonte ishte i varfër dhe se ishte i privuar nga arsimimi i duhur. Gjykata konstatoi se fakti që shkolla e tij frekuentohej pothuajse ekskluzivisht nga fëmijët romë përbënte ndarje. Ajo përsëriti se arsimimi i fëmijëve romë në klasa ose shkolla të ndara pa marrë masat e duhura për korrigjimin e pabarazive nuk ishte në përputhje me detyrën e shtetit për të mos bërë diskriminim në bazë të racës ose etnisë. Gjykata vendosi në bazë të nenit 46 (forca detyruese dhe zbatimi) se shteti hungarez duhej të miratonte masa jo vetëm për t'i dhënë fund ndarjes së nxënësve romë në atë shkollë të caktuar, por për të siguruar zhvillimin e një politike për t'i dhënë fund ndarjes në arsim, siç rekomandohet nga Raporti i Pestë për Hungarinë i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Mosteolerancës (ECRI).

*** Refuzimi i autoriteteve gjermane për të regjistruar një prind transgjinnor si nënë në certifikatën e lindjes së një fëmije të cilin ajo nuk e kishte lindur nuk ka shkelur Konventën (04/04/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **A.H. dhe të tjerët kundër Gjermanisë** (kërkesa nr. 7246/20), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi njëzëri se nuk kishte pasur **shkelje të nenit 8 (e drejtë**



për respektim të jetës private) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me tre parashtrues, i pari prej të cilëve është një prind transgjinnor (A.H.), që u ankua se autoritetet e gjendjes civile kishin refuzuar të regjistronin parashtruesin e parë në regjistrin e lindjeve si nënë të parashtruesit të tretë (L.D.H.) me arsyetimin se A.H. nuk e kishte lindur fëmijën – të cilin e kishte lindur G.H. (parashtruesi i dytë) – i cili në fakt ishte ngjizur me spermën e A.H. Gjykata konstatoi se, në përputhje me synimin e legjislaturës gjermane, gjinia dhe mbiemri i mëparshëm i një prindi transgjinnor duhej të tregohej jo vetëm ku kishte ndodhur lindja para se njohja e ndryshimit të gjinisë së prindit të bëhej përfundimtare, por edhe ku, si në rastin konkret, fëmija ishte ngjizur ose lindur pas riklasifikimit gjinnor. Duke pasur parasysh se nuk ishte vënë në dyshim fakti se parashtruesi i parë (A.H.) ishte prindi i parashtruesit të tretë (L.D.H.) dhe kishte pak skenarë ku identiteti transgjinnor i parashtruesit të parë mund të zbulohet me paraqitjen e certifikatës së lindjes së fëmijës (në të cilën ajo ishte regjistruar si baba), duke marrë gjithashtu parasysh lirinë (“nivelin e vlerësimit”) që i është dhënë shtetit të paditur, Gjykata konstatoi se gjykatat gjermane kishin vendosur një ekuilibër të drejtë mes të drejtave të parashtruesit të parë dhe të dytë (A.H. dhe G.H.), interesave të parashtruesit të tretë (L.D.H.), konsideratave në lidhje me mirëqenien e fëmijës dhe interesat publike në rrezik.

*** Rikthimi me vonesë në punë i prokurorit të pezulluar shkel nenin 8 (04/04/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë** (kërkesa nr. 29943/18), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi njëzëri se kishte pasur **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me z. Gina. Rasti kishte të bënte me një hetim penal kundër parashtruesve me dyshimin për padrejtësi lidhur me deklarimin e pasurisë dhe interesave financiare të tyre ndër vite, si dhe pezullimin e tyre nga pozitat e tyre si prokurorë, siç kërkohet nga legjislacioni përkatës. Gjykata konstatoi se pezullimi i z. Gina ngriti një çështje sipas nenit 8 të Konventës dhe nuk kishte bazë ligjore pasi hetimi penal kundër tij kishte përfunduar, dhe për këtë arsye nuk kishte qenë “në përputhje me ligjin”. Gjykata e hodhi poshtë si të papranueshme ankesën e ngjashme të znj. Gashi për pezullimin e saj dhe rrjedhjen e pretenduar të të dhënave personale në media.

*** Paraburgimi i pajustificuar i dy ish-zyrtarëve të policisë sekrete (04.04.2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin e Radonjić dhe Romić kundër Serbisë (kërkesa nr. 43674/16), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se kishte pasur shkelje të nenit 5 § 3 (e drejta për liri dhe siguri) të Konventës Evropiane për të

Drejtat e Njeriut, dhe shkelje të nenit 5 § 4 (e drejta për të pasur vendim të shpejtë të ligjshmërisë së paraburgimit nga një gjykatë). Rasti kishte të bënte me paraburgimin për gati tri vite e gjysmë të dy ish-zyrtarëve të policisë sekrete të dyshuar për vrasjen e një gazetari dhe publicisti të njohur serb. Ai gjithashtu kishte të bënte me kohëzgjatjen e procedurave para Gjykatës Kushtetuese për vlerësimin e paraburgimit të tyre. Procesi penal vazhdon të jetë në pritje në rastin e tyre. Gjykata nuk gjeti asnjë arsye për të mos u pajtuar me gjetjet e Gjykatës Kushtetuese se viti i parë dhe dy muajt e paraburgimit të tyre ishin justifikuar, mes tjerash, nga nevoja për të ruajtur rendin publik nëse parashtruesit do të ishin liruar duke pasur parasysh natyrën e profilin të lartë të rasti, por që me kalimin e kohës dhe për dy vitet e tre muajt e mbetur të paraburgimit të tyre, kjo arsye nuk ishte më vlefshëm. Edhe pse gjykatat kombëtare kishin pranuar shkeljen e të drejtave të parashtruesve, Gjykata vuri në dukje se atyre nuk u ishte dhënë asnjë kompensim. Rrjedhimisht, ajo refuzoi të pushonte çështjen për mungesë të statusit të viktimës dhe u shpreh se kishte pasur shkelje të nenit 5 § 3. Së fundi, Gjykata vlerësoi se Gjykatës Kushtetuese iu deshën më shumë se dy vite për të vendosur mbi ligjshmërinë e paraburgimit të parashtruesve dhe se kjo nuk mund të konsiderohej si “e shpejtë” sipas kuptimit të nenit 5 § 4 të Konventës.

*** Ndalimi i hyrjes në Sejm për shkak të shfaqjes së një pankarte ka shkelur Konventën (06/04/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin e **Drozd kundër Polonisë** (kërkesa nr. 15158/19), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi njëzëri se kishte pasur **shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me ndalimin një vjeçar të shqiptuar kundër parashtruesve për të hyrë në Sejm (dhoma e ulët e Parlamentit polak). Atyre iu ndalua hyrja për shkak të shfaqjes së një pankarte – ku shkruhej “Mbroni Gjykatat e Pavarura” (Brońcie niezależnych sądów) – në mjediset e Sejmit gjatë një proteste kundër reformave të planifikuara të qeverisë në gjyqësor. Gjykata mendoi se duhej bërë një dallim ndërmjet atij incidenti, i cili kishte ndodhur jashtë ndërtesës së Sejmit, dhe incidenteve brenda të cilat ndërhyenin drejtpërdrejt në zhvillimin e rregullt të debatit parlamentar. Ajo gjeti se ndalimi ishte shqiptuar pa asnjë garanci procedurale. Në veçanti, parashtruesit kishin pranuar thjesht letra nga kreu i Sigurimit të Kuvendit që i informonte se iu ishte ndaluar hyrja, pa ndonjë procedurë të qartë për kundërshtimin e masës.

*** Dështimi për të mbrojtur të drejtën e pacientit për pëlqim të informuar (13/04/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin e **Mayboroda kundër Ukrainës** (kërkesa nr. 14709/07), Gjykata



Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi njëzëri se kishte pasur **shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në lidhje me dështimin për të mbrojtur të drejtën e znj. Mayboroda për pëlqim të informuar. Rasti kishte të bënte me pretendimin e parashtrues se veshka e saj ishte hequr pa pëlqimin apo edhe pa dijeninë e saj gjatë operacionit urgjent sipas pasojë e gjakderdhjes së brendshme në mars të vitit 2000. Ndërhyrja ishte kryer në Spitalin Klinik Rajonal të Lviv, një spital publik. Ajo kishte marrë vesh disa muaj më vonë përmes një telefonate anonime se veshka e majtë “i ishte vjedhur”. Një hetim zyrtar kishte arritur në përfundimin se veshka i ishte hequr për t’i shpëtuar jetën, ndërsa një padi civile që ajo kishte ngritur kishte rezultuar me dëmshtëpërlim ndaj mjekut konsulent. Gjykata konstatoi në veçanti se autoritetet nuk kishin shqyrtuar nëse kishte pasur mundësi për të marrë pëlqimin për heqjen e veshkës qoftë nga znj. Mayboroda para operacionit ose nga të afërmit e saj gjatë procedurës dhe shteti nuk kishte arritur të krijonte një kornizë rregullatore të përshtatshëm për të mbrojtur të drejtën e znj. Mayboroda për pëlqimin e informuar.

*** Shkelja e lirisë së shprehjes së kandidatit në zgjedhjet parlamentare i cili u ndëshkua për shkak se kishte folur turqisht gjatë fushatës (02/05/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Mestan kundër Polonisë** (kërkesa nr. 24108/15), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se kishte pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me një sanksion administrativ të shqiptuar kundër liderit të një partie politike – e mbështetur tradicionalisht nga votuesit që i përkasin pakicës turke në Bullgari – i cili ishte kandidat në zgjedhjet parlamentare bullgare të vitit 2013, për shkak se kishte folur turqisht gjatë fushatës zgjedhore. Autoritetet bullgare kishin menduar se ai kishte shkelur Kodin Zgjedhor Bullgar. Gjykata vuri në dukje se Kodi Zgjedhor Bullgar vendoste një ndalim absolut për përdorimin e çdo gjuhe tjetër përveç gjuhës zyrtare (bullgare) në fushatën zgjedhore dhe se shkeljet e dispozitave përkatëse rezultuan në sanksione administrative në formën e gjobave. Gjykata theksoi rëndësinë e pluralizmit, tolerancës dhe mbrojtjes së pakicave në një shoqëri demokratike dhe vuri në dukje se respekti për pakicat, larg nga dobësimi i demokracive, vetëm mund t’i bëjë ato më të fuqishme. Kështu që, pavarësisht nga kufiri i vlerësimit që u ishte dhënë autoriteteve kombëtare, Gjykata vlerësoi se ndalimi në fjalë nuk korrespondonte me një nevojë të veçantë urgjente dhe nuk ishte në proporcion me qëllimet legjitime të përmendura në nenin 10 të Konventës. Prandaj, ndërhyrja në ushtrimin e së drejtës së parashtruesit për lirinë e shprehjes nuk kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike.

*** Shkelja e të drejtave të një parashtruesi të mbajtur në burg për 44 vite dhe pa pasur asnjë perspektivë realiste për lirinë (09/05/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin e **Horion kundër Belgjikës** (kërkesa nr. 37928/20), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se kishte pasur **shkelje të nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me një parashtrues të paraburgosur që nga viti 1979 dhe të dënuar me burgim të përjetshëm në vitin 1981 për vrasjen e pesë personave në lidhje me një grabitje. Ai ishte ankuar se dënimi me burgim të përjetshëm në rastin e tij është i padiskutueshëm në fakt. Gjykata vuri në dukje se, që nga janari 2018, ekspertët psikiatrikë dhe gjykatat vendore kishin rënë dakord se vazhdimi i mbajtjes së tij në burg nuk ishte më i përshtatshëm, as nga pikëpamja e sigurisë publike, as për qëllime të rehabilitimit dhe ri-integrimit të tij në shoqëri. Prandaj, ata rekomanduan që parashtruesi të pranohej në një njësi psikiatrike forenzike si një fazë e ndërmjetme para lirim të tij të mundshëm. Si rezultat, gjykatat vendore refuzuan të miratojnë çdo ndryshim të dënimit të tij, si burgimi i kufizuar ose mbikëqyrje elektronike, duke theksuar se pranimi i parashtruesit në një njësi psikiatrike forenzike përkatëse ishte hap thelbësor për ri-integrimin e tij në shoqëri. Megjithatë, sipas të njëjtave gjykata, pranimi i parashtruesit në një njësi të tillë “dukej i pamundur në praktikë për shkak të çështjeve të financimit”, pasi njësitë në fjalë marrin subvencione nga shteti vetëm për personat në izolim të detyrueshëm dhe jo për personat e dënuar si parashtruesi. Prandaj, Gjykata vlerësoi se gjendja e vështirë në të cilën ishte gjetur parashtruesi për disa vite për shkak të pamundësisë praktike për të siguruar një vend në një njësi psikiatrike forenzike, megjithëse mbajtja e tij në burg nuk konsiderohej më e përshtatshëm nga autoritetet vendore, nënkuptonte se ai aktualisht nuk kishte asnjë perspektivë realiste për t’u liruar, një situatë e ndaluar nga neni 3 i Konventës.

*** Marrja e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave personale të nevojshme nga Dëshmitarët e Jehovahit për të mbrojtur të drejtat të të tjerëve (09/05/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Dëshmitarët e Jehovahës kundër Finlandës** (kërkesa nr. 31172/19), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi njëzëri se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe as shkelje të nenit 9 (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë). Rasti ka të bëjë me detyrimin e Dëshmitarëve individualë të Jehovahit për të marrë pëlqimin kur mbledhin të dhëna personale gjatë predikimit të tyre derë me derë. Gjykata konstatoi në veçanti se autoritetet vendore kishin balancuar me saktësi interesat e komunitetit parashtrues me të drejtat e



individëve në lidhje me informacionin e tyre personal, duke vlerësuar se marrja e miratimit ishte e nevojshme.

*** Shkelja e lirisë së shprehjes së kandidatit në zgjedhjet parlamentare i cili u ndëshkua për shkak se kishte folur turqisht gjatë fushatës (02/05/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Mestan kundër Polonisë** (kërkesa nr. 24108/15), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se kishte pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me një sanksion administrativ të shqiptuar kundër liderit të një partie politike – e mbështetur tradicionalisht nga votuesit që i përkasin pakicës turke në Bullgari – i cili ishte kandidat në zgjedhjet parlamentare bullgare të vitit 2013, për shkak se kishte folur turqisht gjatë fushatës zgjedhore. Autoritetet bullgare kishin menduar se ai kishte shkelur Kodin Zgjedhor Bullgar. Gjykata vuri në dukje se Kodi Zgjedhor Bullgar vendoste një ndalim absolut për përdorimin e çdo gjuhe tjetër përveç gjuhës zyrtare (bullgare) në fushatën zgjedhore dhe se shkeljet e dispozitave përkatëse rezultuan në sanksione administrative në formën e gjobave. Gjykata theksoi rëndësinë e pluralizmit, tolerancës dhe mbrojtjes së pakicave në një shoqëri demokratike dhe vuri në dukje se respekti për pakicat, larg nga dobësimi i demokracive, vetëm mund t'i bëjë ato më të fuqishme. Kështu që, pavarësisht nga kufiri i vlerësimit që u ishte dhënë autoriteteve kombëtare, Gjykata vlerësoi se ndalimi në fjalë nuk korrespondonte me një nevojë të veçantë urgjente dhe nuk ishte në proporcion me qëllimet legjitime të përmendura në nenin 10 të Konventës. Prandaj, ndërhyrja në ushtrimin e së drejtës së parashtruesit për lirinë e shprehjes nuk kishte qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike.

*** Përdorimi i provave të siguruar duke shkelur të drejtat themelore çoi në dënimin për vrasje (11/05/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës së saj në rastin e **Lalik kundër Polonisë** (kërkesa 47834/19), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se **nuk kishte shkelje të nenit 6 § 3 (c) (e drejta për ndihmë juridike sipas zgjedhjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rasti kishte të bënte me të drejtat e mbrojtjes së parashtruesit dhe privilegjin e mos-vetëinkriminit. Në janar të vitit 2016, ndërsa ishte i dehur, parashtruesi i vuri flakën xhakëtës së personit me të cilën ishte duke pirë, duke i shkaktuar djegie të rënda dhe vdekjen si pasojë. Parashtruesi u dënua për vrasje të rëndë dhe u dënua me 25 vite burgim. Aktgjykimet e gjykatave kombëtare iu referuan shprehimisht deklaratave që ai kishte bërë gjatë marrjes në pyetje të tij joformale, të cilat kishin ndodhur para se ai ta takonte avokatin dhe dyshohet se ishte ende nën efektin e alkoolit. Gjykata konstatoi në veçanti se

z. Lalik nuk ishte informuar siç duhet për të drejtat e tij të mbrojtjes. Ajo shprehu shqetësimin se gjykatat kombëtare kishin pranuar dhe vlerësuar provat e marra në kundërshtim me këto garanci themelore. Shpjegimet që z. Lalik kishte dhënë gjatë marrjes në pyetje joformale, kishin shërbyer si prova kyçe për të vërtetuar qëllimin e tij për të vrarë mikun e tij, gjë që nga ana e tij kishte çuar në dënimin e tij për vrasje. Në vështrimin e Gjykatës, një arsyetim i tillë ishte kundër konceptit të një procesi të drejtë.

*** Dënimi i parashtruesit për mosfshirjen e menjëhershme të komenteve të paligjshme në Facebook nuk ka shkelur të drejtën e tij për lirinë e shprehjes (15/05/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin e **Sanchez kundër Francës** (kërkesa nr. 45581/15), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi njëzëri se nuk **kishte pasur shkelje të nenit 10 (liria e shprehjes)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kërkesa kishte të bënte me dënimin penal të parashtruesit, i cili në atë kohë ishte këshilltar lokal dhe kandidonte për zgjedhjet në Parlament, për veprën penale të nxitjes së urrejtjes ose dhunës kundër një grupi ose një individi në bazë të besimit fetar, pasi nuk mori veprime të menjëhershme për të fshirë komentet e postuara nga palë të treta në “murin” e llogarisë së tij në Facebook. Parashtruesi kishte pretenduar se dënimi i tij kishte shkelur të drejtën e tij për lirinë e shprehjes sipas nenit 10 të Konventës. Çështja penale kishte vënë në qendër mungesën e kujdesit dhe mosveprimin e parashtruesit në lidhje me komentet e postuara nga të tjerët. Kjo kishte ngritur çështjen e përgjegjësisë së ndarë të akterëve të ndryshëm të përfshirë në media sociale. Gjykatat penale franceze, duke zbatuar regjimin e “përgjegjësisë së përshkallëzuar” të paraqitur nga ligji i 29 korrikut 1982, kishin dënua autorët për mesazhet e paligjshme së bashku me parashtruesin si mbajtës të llogarisë në Facebook, duke u cilësuar si “prodhues”. Së pari, Gjykata vlerësoi se korniza ligjore vendore, që parashikonte ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve, ishte mjaft e qartë, për qëllime të nenit 10 të Konventës, për t'i mundësuar parashtruesit të rregullonte sjelljen e tij në këto rrethana. Së dyti, Gjykata u pajtua me gjykatat vendore se komentet në fjalë, të cilat ishin postuar në kontekstin e veçantë të zgjedhjeve të ardhshme, mund të klasifikoheshin si gjuhë e urrejtjes, kur interpretoheshin dhe analizoheshin në kuptimin e ndikimit të tyre të menjëhershëm, dhe për këtë arsye ishin të paligjshme. Së treti, ajo mendoi se ndërhyrja në lirinë e shprehjes së parashtruesit ndiqte jo vetëm qëllimin legjitim të mbrojtjes së reputacionit ose të drejtave të të tjerëve, por edhe qëllimin e parandalimit të çështjeve të rendit publik ose kriminit. Sipas Gjykatës, duke pasur parasysh se parashtruesi kishte vendosur të bënte “murin” e tij në Facebook të qasshëm për publikun dhe kishte “autorizuar miqtë e tij për të postuar komente”, ai nuk mund të mos ishte në dijeni, duke pasur parasysh tensionet lokale dhe fushatën zgjedhore aktuale rreth

asaj kohe, se zgjedhja e tij nuk ishte pa dyshim pa pasoja të caktuara potencialisht të rënda. Gjykata, duke marrë në konsideratë kufirin e vlerësimit të shtetit, arriti në përfundimin se vendimet e gjykatave vendore ishin bazuar në arsye të rëndësishme dhe të mjaftueshme, në lidhje si me përgjegjësinë e parashtruesit, si politikan, për komentet e paligjshme të postuara nga palët e treta të cilët ishin identifikuar dhe ndjekur penalisht si bashkëpunëtorë, ashtu dhe për dënimin penal të parashtruesit. Ndërhyrja në fjalë mund të konsiderohet si “e nevojshme në një shoqëri demokratike”. Prandaj, nuk kishte pasur shkelje të nenit 10 të Konventës.

*** Nuk ka pasur shkelje të të drejtave të ish-Presidentit të Kroacisë në artikullin e lajmeve në internet që përmendet përfshirja e tij të mundshme në korrupsion (30/05/2023)**

Në aktgjykimin e Dhomës në rastin **Mesić kundër Kroacisë** (nr. 2) (*kërkesa nr. 45066/17*), Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut vendosi, me pesë vota për dhe dy kundër, se **nuk kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private)** të Konventës Evropiane për të Drejtave të Njeriut.

Rasti kishte të bënte me një artikull të publikuar në shkurt të vitit 2015 nga një portal lajmesh në internet Dnevno.hr që sugjeronte se parashtruesit, ish-Presidentit të Kroacisë, gjatë mandatit të tij i ishte ofruar ose kishte marrë ryshfet në lidhje me prokurimin e automjeteve të blinduara për ushtrinë kroate nga kompania finlandeze Patria.

Z. Mesic u ankua se duke hedhur poshtë padinë e tij civile për kompensim, gjykatat vendore nuk kishin mbrojtur reputacionin e tij duke shkelur të drejtën e tij për respektimin e jetës private. Gjykata vuri në dukje se artikulli nuk kishte synuar jetën private të z. Mesic, por i ishte referuar sjelljes së tij gjatë ushtrimit të detyrave të tij zyrtare dhe, në raportimin e asaj që ishte deklaruar në dokumentet zyrtare, nuk kishte deklaruar qartë se ai kishte marrë pjesë në veprimtari kriminale. Në veçanti, ajo potencoi se gjykatat kroate kishin vendosur një ekuilibër të drejtë mes të drejtës së ish-Presidentit për respektimin e jetës së tij private dhe të drejtës së portalit të lajmeve për lirinë e shprehjes.

(Për më shumë hollësi vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: www.echr.coe.int)

INFORMATA PËR GJYKATËN

Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen “Pejton”. Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuar në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është rasti me ndërtimin e sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimin e Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011.

Objekti i Gjykatës ka gjithsej 1 937 m² hapësirë të shfrytëzueshme për punë, që shfrytëzohet nga 65 punonjës.



ADRESA

Rruga: “Perandori Justinian”, nr. 44, 10 000 - Prishtinë

Tel: +383 (0)38 60 61 62

Mob: +383 (0)45 200 595; +383 (0)45 200 576

Fax: +383 (0)38 60 61 70

E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org

Ueb: www.gjk-ks.org